



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L -053

**PËR DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRËN E PROKURORIT TË
SPECIALIZUAR**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton,

**LIGJ PËR DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRËN E
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR**

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Fusha e veprimit dhe qëllimi i ligjit

1. Me këtë ligj themelohet dhe rregullohet organizimi, funksionet dhe juridiksioni i Dhomave të specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të specializuar.
2. Dhomat e specializuara brenda sistemit të drejtësisë së Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të specializuar janë të domosdoshme për përmbushjen e obligimeve ndërkombëtare të parapara në Ligjin nr. 04/L-274, për garantimin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe për garantimin e procedurave penale të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase në lidhje me pretendimet për krime të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare të kryera gjatë konfliktit në Kosovë dhe pas

tij, krime të cilat ndërlidhen me ato që janë raportuar në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës Dok 12462, i datës 7 janar 2011, dhe të cilat kanë qenë objekt i hetimeve penale të kryera nga Task Forca Hetimore Speciale (“TFHS”) e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (“PSRK”).

Neni 2

Përputhshmëria me Nenin 55 të Kushtetutës

Çdo kufizim i të drejtave dhe lirive themelore bëhet në përputhje me nenin 55 të Kushtetutës për qëllime objektive dhe të arsyeshme që janë shprehur në këtë nen, në pajtim me kapitullin II të Kushtetutës dhe standardet ndërkombëtare të drejtësisë dhe procesit të drejtë. Këto qëllime janë në interesin e Kosovës si shoqëri e hapur dhe demokratike dhe janë në shërbim të përmbushjes së obligimeve ndërkombëtare të Kosovës. Në përputhje me nenin 55 të Kushtetutës, këto kufizime shqiptohen vetëm në masën e nevojshme për përmbushjen e këtyre qëllimeve jetike.

KAPITULLI II

PARIMET THEMELORE

Neni 3

Parimet themeluese

1. Dhomat e specializuara janë pjesë përbërëse e çdo niveli të sistemit të gjykatave në Kosovë: Gjykatës Themelore të Prishtinës, Gjykatës së Apelit, Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese do të merret ekskluzivisht me referimet kushtetuese lidhur me Dhomat e Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Dhomat e Specializuara janë të pavarura në ushtrimin e funksioneve të tyre.

2. Dhomat e specializuara gjykojnë dhe funksionojnë në përputhje me:

- a. Kushtetutën e Republikës së Kosovës,
- b. këtë Ligj si *lex specialis*,
- c. dispozitat e tjera të ligjeve të Kosovës të përfshira shprehimisht në këtë ligj dhe të zbatuara nga ky ligj,
- d. të drejtën zakonore ndërkombëtare së cilës i është dhënë përparësi kundrejt ligjeve vendase me nenin 19(2) të Kushtetutës, dhe
- e. të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që përcakton standardet e drejtësisë penale përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe Marrëveshjen Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilave iu është dhënë përparësi kundrejt ligjeve vendore me nenin 22 të Kushtetutës.

3. Për përcaktimin e së drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën kur janë kryer krimet, gjyqtarët mund të ndihmohen nga burime të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë burime dytësore siç janë jurisprudenca nga tribunalet ndërkombëtare *ad hoc*, Gjykata Ndërkombëtare Penale dhe gjykatat e tjera penale.

4. Çdo ligj, rregullore, rregullore dytësore, rregull ose zakon tjetër dhe praktikë e Kosovës, që nuk janë përfshirë shprehimisht në këtë ligj, nuk zbatohen për organizimin, administrimin, funksionet apo juridiksionin e Dhomave të specializuara dhe zyrës së Prokurorit të specializuar. Ky ligj mbizotëron mbi çdo dispozitë kundërthënëse të çfarëdo ligji apo rregulloreje tjetër.

5. Dhomat e specializuara mbështeten nga një Zyre Administrative, që po ashtu i administron të gjitha funksionet e nevojshme dhe ndihmëse, përfshirë qendrat e paraburgimit, siç parashikohet nga ky ligj.

6. Dhomat e specializuara kanë njëë seli në Kosovë. Siç përcaktohet me anë të një marrëveshjeje ndërkombëtare me shtetin pranues, Dhomat e specializuara po ashtu kanë seli edhe në shtetin pranues jashtë Kosovës, por në raste të jashtëzakonshme mund të mblidhen edhe gjetiu nëse një gjë e tillë është e domosdoshme për interesat e administrimit të duhur të drejtësisë. Dhomat e specializuara mund të bëjnë aranzhime të posaçme për dhënien e dëshmimeve apo paraqitjeve përmes mënyrave alternative sipas diskrecionit të gjyqtarëve.

7. Siç parashikohet përmes një marrëveshjeje ndërkombëtare me shtetin pranues, Prokuroria e specializuar do ta ketë njëë seli në shtetin pranues, por mund të ketë seli edhe në Kosovë. Zyra e Prokurorit të Specializuar mund t'i kryejë funksionet e saj në selinë që zgjedh vet Zyra e Prokurorit të Specializuar apo gjetiu, varësisht kërkesave për përmbushje efektive të mandatit të saj.

8. Për arsye të administrimit të duhur të drejtësisë ose sigurisë,

a. Kryetari i Dhomave të Specializuara, Prokurori i Specializuar, Mbrojtësi i Specializuar ose Mbrojtësi i Viktimave mundën, sipas diskrecionit të tyre, të kërkojnë që të bëhet ndryshimi i vendit tek shteti pranues për shqyrtim gjyqësor, cilëndo pjesë të shqyrtimit gjyqësor, ose ndonjë fazë apo disa fazave të caktuara të procedurës penale sipas këtij Ligji,

b. Prokurori i Specializuar, Mbrojtësi i Specializuar, Mbrojtësi i Viktimave, ose ndonjë palë a person tjetër me kompetencë për të vepruar kështu sipas këtij ligji, mund të paraqesë ose të kërkojë çfarëdo dokumenti të gjykatës, parashtrere, dokumenti, propozimi, kërkesë ose sendi tjetër në selinë e Dhomave të Specializuara në shtetin pranues,

c. Prokurori i Specializuar ose Kryetari i Trupit Gjyqësor të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese gjithashtu mund, sipas diskrecionit të tyre, të kërkojnë ndryshim të vendit për mbajtjen e seancave të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, me qëllim që ky trup gjyqësor të mblidhet, të shqyrtojë dhe t'i pranojë parashtrësit në selinë e Dhomave të Specializuara në shtetin pranues;

d. në rastin kur vendoset ndryshimi i vendit tek shteti pranues, Kryetari i Dhomave të Specializuara nxjerrë vendim administrativ për ndërrimin e lokacionit të zhvillimit të procedurës, apo të ndonjë pjese apo faze të saj, tek shteti pranues dhe i urdhëron të gjitha hapat e nevojshëm për zbatimin e këtij vendimi;

Neni 4 Personaliteti dhe zotësia juridike

1. Dhomat e specializuara dhe Prokuroria e specializuar kanë personalitet të plotë ligjor dhe juridik.
2. Dhomat e specializuara, Zyra Administrative dhe Zyra e Prokurorit të specializuar mund të bëjnë marrëveshje me shtete, organizata ndërkombëtare dhe subjekte të tjera, me qëllim të përmbushjes së mandatit të tyre ose për realizimin e operacioneve të tyre në pajtim me këtë ligj, në veçanti në lidhje me bashkëpunimin, asistencën gjyqësore dhe vuajtjen e dënimit.
3. Kryetari i Dhomave të specializuara, Administratori dhe Prokurori i specializuar, ose, në mungesë të tyre, zëvendësit e tyre, mund t'i përfaqësojnë organet dhe subjektet e tyre përkatëse për ushtrimin ose ndërmarrjen e funksioneve të tyre dhe për arritjen e marrëveshjeve të nevojshme.
4. Para arritjes së ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare me një shtet të tretë lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar që përndryshe kërkon ratifikim sipas Nenit 18 të Kushtetutës, Dhomat e Specializuara do të marrin pëlqimin e Qeverisë së Kosovës.

Neni 5 Mandati ekzekutiv dhe veprimi

Në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, të gjitha kompetencat dhe autoritetet e nevojshme ekzekutive, që kërkohen për veprimin e Dhomave të specializuara, organeve të tyre dhe të gjitha funksioneve përkatëse të tyre sipas këtij Ligji do të delegohen në pajtueshmëri me Ligjin 04/L-274.

KAPITULLI III JURIDIKSIONI DHE LIGJI I ZBATUESHËM

Neni 6 Juridiksioni lëndor

1. Dhomat e specializuara kanë juridiksion mbi krimet e parapara në nenet 12 – 16 që kanë të bëjnë me Raportin e Asamblesë së Këshillit të Evropës.
2. Dhomat e Specializuara po ashtu kanë juridiksion mbi veprat e parapara në kapitullin XXXII, nenet 384-386, 388, 390-407, dhe kapitullin XXXIII nenet 409-411, 415, 417, 419,

421, dhe Kapitullin XXXIV, nenet 423-424 të Kodit Penal të Kosovës i vitit 2012, Ligji 04/L-082, kur ato kanë të bëjnë me procedurat zyrtare dhe zyrtarët e tyre.

Neni 7 **Juridiksioni kohor**

Dhomat e specializuara kanë juridiksion mbi veprat penale në kuadër të juridiksionit lëndor të tyre të cilat janë kryer mes periudhës 1 janar 1998 dhe 31 dhjetor 2000.

Neni 8 **Juridiksioni territorial**

Në përputhje me juridiksionin territorial të gjykatave të Kosovës sipas ligjeve penale të zbatueshme që kanë qenë në fuqi mes periudhës 1 janar 1998 dhe 31 dhjetor 2000, Dhomat e specializuara kanë juridiksion mbi veprat penale që bien nën juridiksionin lëndor të tyre të cilat janë filluar ose janë kryer në Kosovë.

Neni 9 **Juridiksioni personal**

1. Dhomat e Specializuara kanë juridiksion mbi personat fizikë sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Në përputhje me juridiksionin e personalitetit aktiv dhe pasiv të gjykatave të Kosovës sipas ligjeve penale të zbatueshme që kanë qenë në fuqi në mes të periudhës 1 janar 1998 dhe 31 dhjetor 2000, dhe përveç juridiksionit të tyre territorial të paraparë në nenin 8, Dhomat e specializuara kanë juridiksion mbi personat e nënshtetësisë Kosovare/IRJ apo mbi personat që kanë kryer krime në kuadër të juridiksionit të tyre lëndor kundër personave me nënshtetësi kosovare/IRJ kudo që janë kryer ato krime.

Neni 10 **Juridiksioni i njëkohshëm**

1. Brenda juridiksionit lëndor të tyre, Dhomat e specializuara kanë përparësi mbi të gjitha gjykatat e tjera të Kosovës.

2. Në çdo fazë të hetimeve ose procedurave, Dhomat e specializuara ose prokurori i specializuar mund të urdhërojnë transferimin e procedurës brenda juridiksionit të tyre nga ndonjë prokuror tjetër ose ndonjë gjykatë tjetër [përveç Gjykatës Kushtetuese] në territorin e Kosovës tek Dhomat e specializuara dhe prokurori i specializuar. Prokurori i shtetit ose gjykata u përcjell Dhomave të specializuara çdo shkresë dhe të gjitha shkresat që i përkasin lëndës së kërkuar. Urdhri i Dhomave të specializuara për transferim është përfundimtar dhe detyrues.

3. Ligji për Gjykatat, Ligji nr. 03/L-199, dhe Ligji nr. 03/L-053 për juridiksionin dhe kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, nuk vlejnë për çështjet

që janë para Dhomave të specializuara dhe Prokurorisë së specializuar, ose për çështjet që janë objekt i ndonjë urdhri për t'iu transferuar Dhomave të specializuara dhe Prokurorisë së specializuar.

Neni 11 **Njoftimi për Rastet dhe Procedurat Penale**

Të gjitha gjykatat dhe prokurorët e Kosovës i njoftojnë Dhomat e specializuara dhe Prokurorinë e specializuar pa vonesë nëse kanë dijeni për ndonjë rast ose procedurë penale që përfshihet në juridiksionin lëndor të Dhomave të specializuara.

Neni 12 **Ligji i zbatueshëm**

Dhomat e Specializuara zbatojnë të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe ligjin penal material të zbatueshëm në Kosovë përderisa ai është në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare, që ka qenë i zbatueshëm në kohën që janë kryer krimet, në pajtim me nenin 7(2) të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe nenin 15(2) të Marrëveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të përfshira dhe të mbrojtura me nenet 19 (2), 22(2), 22(3) dhe 33(1) të Kushtetutës.

Neni 13 **Krimet Kundër Njerëzimit sipas së Drejtës Ndërkombëtare**

Për qëllime të këtij ligji, në bazë të së drejtës zakonore ndërkombëtare gjatë juridiksionit kohor të Dhomave të Specializuara, krime kundër njerëzimit janë veprat e paraqitura në vijim, kur ato kryhen si pjesë e ndonjë sulmi të gjerë ose sistematik të drejtuar kundër popullatës civile, duke qenë në dijeni për sulmin:

- a. vrasja,
- b. shfarosja,
- c. skllavërimi,
- d. dëbimi,
- e. burgosja,
- f. tortura,
- g. përdhunimi seksual, skllavërimi seksual, prostitucioni i detyruar, shtatzënia e detyruar dhe çdo formë tjetër e dhunës seksuale,
- h. përndjekja mbi baza politike, racore, etnike ose fetare,

- i. zhdukja e detyruar e personave dhe
- j. veprimet e tjera çnjerëzore.

Neni 14 **Krimet e Luftës sipas së Drejtës Ndërkombëtare**

1. Për qëllime të këtij ligji, sipas së drejtës ndërkombëtare zakonore gjatë juridiksionit kohor të Dhomave të specializuara, me krime të luftës nënkuptohet:

a. shkeljet e rënda të Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949, duke i përfshirë veprat në vijim të kryera kundër personave apo pronës që janë të mbrojtur me dispozitat e Konventës përkatëse të Gjenevës:

- (i) vrasjen e qëllimshme,
- (ii) torturën apo trajtimin çnjerëzor, përfshirë eksperimentet biologjike,
- (iii) shkatërrimin e qëllimshëm të vuajtjeve të rënda, apo lëndimeve të rënda të trupit apo shëndetit,
- (iv) shkatërrimin masiv dhe marrjen e pronës, të paarsyetuara me domosdoshmëri ushtarake dhe të kryera në mënyrë të paligjshme dhe pa shkak,
- (v) detyrimin e të burgosurve të luftës apo të personave të tjerë të mbrojtur që të shërbejnë në forcat e armikut,
- (vi) privimin e qëllimshëm të burgosurve të luftës apo të personave të tjerë të mbrojtur nga e drejta për proces gjyqësor të drejtë dhe të rregullt,
- (vii) dëbimin apo transferimin e paligjshëm apo izolimin e paligjshëm dhe
- (viii) marrjen e pengjeve.

b. shkeljet e tjera të rënda të ligjeve dhe zakoneve të zbatueshme në konflikte të armatosura ndërkombëtare, të njohura si të tilla në të drejtën ndërkombëtare zakonore, duke i përfshirë veprat e paraqitura në vijim, por jo vetëm ato:

- (i) drejtimin e qëllimshëm të sulmeve kundër popullatës civile apo kundër civilëve individualë që nuk marrin pjesë drejtpërdrejtë në luftime,
- (ii) drejtimin e qëllimshëm të sulmeve kundër objekteve civile, pra, objekteve që nuk janë caqe ushtarake,
- (iii) drejtimin e qëllimshëm të sulmeve kundër personelit, instalimeve, materialeve, njësive apo automjeteve që janë të përfshira në dhënien e ndihmës humanitare apo në misione paqeruajtëse në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara, nëse ato e gëzojnë mbrojtjen që ju jepet civilëve apo objekteve civile me të drejtën ndërkombëtare për konfliktet e armatosura,
- (iv) nisjen e qëllimshme të sulmit duke e ditur se ky sulm do të shkaktojë humbje të rastësishme të jetës apo lëndimin e civilëve apo dëme ndaj objekteve civile apo dëme të gjera, afatgjate dhe të rënda ndaj mjedisit natyror [për të cilat është e qartë se do të jenë të tepruara në lidhje me përparësinë ushtarake të përgjithshme konkrete dhe të drejtpërdrejtë që pritet],

- (v) sulmimin apo bombardimin, me çfarëdo mjete, të qyteteve, fshatrave, vendbanimeve apo ndërtesave që janë të pambrojtura dhe që nuk janë caqe ushtarake,
- (vi) vrasjen apo plagosjen e ndonjë luftëtari i cili, pasi që i ka dorëzuar armët e tij apo i cili më nuk ka mjete për mbrojtje, është dorëzuar pa kushte,
- (vii) përdorimin jo të duhur të flamurit të armëpushimit, të flamurit apo shenjave ushtarake dhe uniformave të armikut apo të Kombeve të Bashkuara, si dhe të emblemave dalluese të Konventave të Gjenevës, që rezultojnë me vdekje apo me lëndime të rënda personale,
- (viii) transferimin, e drejtpërdrejtë apo të tërthortë, nga ana e forcave okupuese të pjesëve të popullatës së vet civile nëpër territoret që ajo i okupon, apo dëbimin apo transferimin e të gjithë popullatës apo të ndonjë pjese të popullatës së territorit të okupuar brenda apo jashtë atij territori,
- (ix) drejtimin e qëllimshëm të sulmeve kundër ndërtesave të dedikuara për religjion, arsim, art, shkencë apo për qëllime bamirësie, monumenteve historike, spitaleve dhe vendeve ku janë të mbledhur të sëmurit dhe të plagosurit, nëse ato nuk janë caqe ushtarake,
- (x) nënshkrimin e personave të cilët janë nën autoritetin e palës kundërshtare ndaj gjytimeve fizike apo ndaj çfarëdo eksperimenti mjekësor apo shkencor që nuk arsyetohet me trajtimin mjekësor, stomatologjik apo spitalor të personit përkatës e as që nuk kryhen për interesin e tij, [dhe që do ta shkaktojnë vdekjen e atij personi apo personave apo rrezikimin e rëndë të shëndetit të tyre],
- (xi) vrasjen apo plagosjen tradhtare të individëve që i përkasin kombit apo ushtrisë së armikut,
- (xii) deklarimin se nuk do të ketë mëshirë,
- (xiii) shkatërrimin apo sekuestrimin e pronës së armikut nëse ai shkatërrim apo sekuestrim nuk kërkohet me doemos nga domosdoshmëria e luftës,
- (xiv) shpalljen e të drejtave dhe veprimeve të bashkëkombësve të palës armiqësore si të shfuqizuara, të pezulluara apo të papranueshme para gjykatës,
- (xv) detyrimin e bashkëkombësve të palës armiqësore për të marrë pjesë në operacionet e luftës të drejtuara kundër shtetit të tyre, edhe nëse ata kanë qenë në shërbimin e palës ndërluftuese para fillimit të luftës,
- (xvi) plaçkitjen e ndonjë qyteti apo vendi, edhe kur ai merret përmes sulmit,
- (xvii) përdorimin e helmeve apo e armëve të helmuara,
- (xviii) përdorimin e gazrave asfiksues, helmues apo të tjerë, dhe e të gjitha llojeve të lëngjeve, materialeve apo pajisjeve analoge,
- (xix) përdorimin e plumbave që zgjerohen apo rrafshohen lehtë në trupin e njeriut, si plumbat me mbështjellës të fortë i cili nuk e mbulon plotësisht pjesën qendrore apo që shpohet me prerje,
- (xx) përdorimin e armëve, predhave dhe materialeve dhe metodave të luftës të cilat janë të asaj natyre që shkaktojnë lëndime të tepruara apo vuajtje të panevojshme apo të cilat vetvetiu nuk bëjnë dallim në shkeljen e të drejtës ndërkombëtare për konfliktet e armatosura, duke qenë se këto armë, predha dhe materiale dhe metoda të luftës i nënshtrohen [një ndalimi gjithëpërfshirës dhe janë të përfshira në shtojcën e këtij statuti

- me anë të një amendamenti në përputhje me dispozitat përkatëse të përcaktuara në Nenet 121 dhe 123],
- (xxi) cenimin e dinjitetit personal, në veçanti trajtimet poshtëruese dhe denigruese,
 - (xxii) dhunimet seksuale, skllavërimi seksual, prostituimi i detyruar, shtatzënia me dhunë, sterilizimi i detyruar, ose çdo formë tjetër e dhunës seksuale që po ashtu përbënë shkelje të rëndë të Konventave të Gjenevës,
 - (xxiii) përdorimin e pranisë së ndonjë personi civil apo person tjetër të mbrojtur për t'i bërë pikat, zonat apo forcat e caktuara ushtarake të paprekura nga operacionet ushtarake,
 - (xxiv) drejtimin e qëllimshëm të sulmeve kundër ndërtesave, materialeve, njësive dhe transportit mjekësor dhe personelit që përdorë emblema dalluese të Konventave të Gjenevës në përputhje me të drejtën ndërkombëtare,
 - (xxv) përdorimin e qëllimshëm të urisë së civilëve si metodë e luftimeve duke ua mohuar atyre objektet që janë të pashmangshme për mbijetesë, përfshirë pengimin me paramendim të furnizimeve të ndihmave ashtu siç parashihet në Konventat e Gjenevës,
 - (xxvi) rekrutimin e fëmijëve nën moshën pesëmbëdhjetëvjeçare në forcat e armatosura të shtetit apo shfrytëzimi i tyre për të marrë pjesë aktive në luftime.

c. në rast të ndonjë konflikti të armatosur që nuk është i karakterit ndërkombëtar, shkeljet e rënda të Nenit 3, që është i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949, duke i përfshirë veprat në vijim të kryera kundër personave që nuk janë pjesë aktive e luftimeve, përfshirë kundër pjesëtarëve të forcave të armatosura që i kanë dorëzuar armët dhe atyre që janë *hors de combat* [jashtë veprimt] për shkak të sëmundjes, plagëve, paraburgimit apo ndonjë arsyeje tjetër:

- i) dhuna kundër jetës dhe personit, në veçanti vrasjet e të gjitha llojeve, gjymtimi, trajtimi mizor dhe tortura,
- ii) cenimi i dinjitetit personal, në veçanti trajtimet poshtëruese dhe degraduese,
- iii) marrja e pengjeve,
- iv) shqiptimi e dënimeve dhe kryerja e ekzekutimeve pa gjykime paraprake të shpallura nga ndonjë gjykatë e themeluar në mënyrë të rregullt, që siguron të gjitha garancitë gjyqësore që janë të pranuar në përgjithësi si të domosdoshme.

d. Shkeljet e tjera të rënda të ligjeve dhe të zakoneve të zbatueshme në konflikte të armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar, të njohura si të tilla në të drejtën zakonore ndërkombëtare, duke i përfshirë veprat në vijim, por jo vetëm ato:

- i) drejtimin e qëllimshëm të sulmeve kundër popullatës civile apo kundër civilëve individualë që nuk marrin pjesë drejtpërdrejtë në luftime,
- ii) drejtimin e qëllimshëm të sulmeve kundër ndërtesave, materialeve, njësive dhe transportit mjekësor dhe personelit që përdorë emblema dalluese të Konventave të Gjenevës në përputhje me të drejtën ndërkombëtare,

- iii) drejtimin e qëllimshëm të sulmeve kundër personelit, instalimeve, materialeve, njërive apo automjeteve që janë të përfshira në dhënien e ndihmës humanitare apo në misione paqeruajtëse në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara, nëse ato e gëzojnë mbrojtjen që ju jepet civilëve apo objekteve civile me të drejtën ndërkombëtare për konfliktet e armatosura,
- iv) drejtimin e qëllimshëm të sulmeve kundër ndërtesave të dedikuara për religjion, arsim, art, shkencë apo për qëllime bamirësie, monumenteve historike, spitaleve dhe vendeve ku janë të mbledhur të sëmurit dhe të plagosurit, nëse ato nuk janë caqe ushtarake,
- v) plaçkitjen e ndonjë qyteti apo vendi, edhe kur ai merret përmes sulmit,
- vi) dhunimet seksuale, skllavërimi seksual, prostituimi i detyruar, shtatzënia me dhunë, sterilizimi i detyruar, ose çdo formë tjetër e dhunës seksuale që po ashtu përbënë shkelje të rëndë të Nenit 3 i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës,
- vii) rekrutimin e fëmijëve nën moshën pesëmbëdhjetëvjeçare në forcat ose grupet e armatosura apo shfrytëzimi i tyre për të marrë pjesë aktive në luftime,
- viii) urdhërimin e zhvendosjes së popullatës civile për arsye që lidhen me konfliktin, përveç nëse kjo kërkohet nga arsyet që lidhen me sigurinë e civilëve të përfshirë dhe me domosdoshmërinë ushtarake,
- ix) vrasjen apo plagosjen tradhtare të luftëtarit të armikut,
- x) deklarimin se nuk do të ketë mëshirë,
- xi) nënshtrimin e personave të cilët janë nën autoritetin e palës tjetër në konflikt ndaj gjymtimeve fizike apo ndaj çfarëdo eksperimenti mjekësor apo shkencor që nuk arsyetohet me trajtimin mjekësor, stomatologjik apo spitalor të personit përkatës e as që nuk kryhen për interesin e tij, [dhe që do ta shkaktojnë vdekjen e atij personi apo personave apo rrezikimin e rëndë të shëndetit të tyre],
- xii) shkatërrimin apo sekuestrimin e pronës së armikut nëse ai shkatërrim apo sekuestrim nuk kërkohet me doemos nga domosdoshmëria e konfliktit,
- xiii) përdorimin e helmeve apo e armëve të helmuara,
- xiv) përdorimin e gazrave asfiksues, helmues apo të tjerë, dhe e të gjitha llojeve të lëngjeve, materialeve apo pajisjeve analoge dhe
- xv) përdorimin e plumbave që zgjerohen apo rrafshohen lehtë në trupin e njeriut, si plumbat me mbështjellës të fortë i cili nuk e mbulon plotësisht pjesën qendrore apo që shpohet me prerje.

2. Neni 14(1)(c) dhe (d) vlejné për konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtare dhe nuk vlejné për situatat e prishjes së rendit dhe tensioneve të brendshme, siç janë trazirat, veprimet e izoluara apo sporadike të dhunës dhe veprimet e tjera të një natyre të ngjashme. Ato vlejné për konfliktet e armatosura që ndodhin në territorin e ndonjë shteti kur ekziston konflikt i armatosur i zgjatur mes organeve të autoritetit dhe grupeve të armatosura të organizuara apo mes grupeve të tilla.

Neni 15

Krime të tjera sipas së drejtës së Kosovës

1. Në varshmëri të nenit 12 dhe në pajtueshmëri me Rregulloren 1999/24 të UNMIK-ut, të ndryshuar me Rregulloren 2000/59 të UNMIK-ut, ligjet penale materiale në fuqi gjatë juridiksionit kohor të Dhomave të specializuara sipas së drejtës së Kosovës kanë qenë:

- a. Kodi Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (1976); dhe
- b. Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (1977); ose
- c. Çdo ligj penal material më i butë që ka qenë në fuqi nga viti 1989 deri në korrik 1999/27 tetor 2000.

2. Kapitulli XXXII, nenet 384-386, 388, 390-407, dhe kapitulli XXXIII nenet 409-411, 415, 417, 419, 421, dhe Kapitullin XXXIV, nenet 423-424 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2012, Ligji 04/L-082, zbatohen për procedurat zyrtare dhe zyrtarët e Dhomave të specializuara, Zyrës së regjistrimit dhe Prokurorisë së specializuar. Dhomat e specializuara kanë juridiksion mbi këto vepra kur ato ndërlidhen me procedurat zyrtare dhe zyrtarët e tyre.

Neni 16

Përgjegjësia penale individuale

1. Për krimet nga nenet 13-14,

- a. personi i cili ka planifikuar, nxitur, urdhëruar, kryer ose në ndonjë mënyrë tjetër ka ndihmuar dhe ka dhënë mbështetje për planifikimin, përgatitjen ose ekzekutimin e këtij krimi, mban përgjegjësi individuale për krimin,
- b. pozita zyrtare e të akuzuarit, qoftë si kryetar i shtetit, kryeministër apo zyrtar i qeverisë, nuk e liron këtë person nga përgjegjësia penale, as nuk ia zbut dënimin,
- c. fakti që ndonjëri prej veprimeve ose mosveprimeve është kryer nga një vartës nuk e liron eprorin e tij nga përgjegjësia penale, në rast se ai e ka ditur apo ka pasur arsye ta dijë se vartësi kishte ndërmend t'i kryente ato veprime ose i kishte kryer dhe eprori nuk mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme për t'i parandaluar ato veprime, ose për t'i dënuar kryerësit e tyre,
- d. fakti që i akuzuari ka vepruar në zbatim të urdhrit të qeverisë ose të eprorit, nuk e liron atë nga përgjegjësia penale, por mund të merret parasysh në zbutjen e dënimit në rast se Dhomat e specializuara përcaktojnë se këtë e kërkon drejtësia.

2. Për krimet nga neni 15 (1) zbatohen ligjet e Kosovës për përgjegjësinë penale individuale që ishin në fuqi në kohën e krimit [nenet 8, 11, 13-15, 18-19, 22-26, 253-254 të KPRSFJ].

3. Për krimet nga neni 15(2) zbatohen dispozitat për përgjegjësinë penale individuale të përmbajtura në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2012, Ligji nr. 04/L-082 [nenet 8-10, 17, 21-24, 27-40].

Neni 17 **Non-bis-in-idem**

Në pajtim me nenin 34 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

- a. askush nuk gjykohet para një gjykate tjetër të Kosovës për vepra për të cilat ai është gjykuar tashmë nga Dhomat e specializuara,
- b. askush nuk gjykohet para Dhomave të specializuara për vepra për të cilat ai veçse është gjykuar nga ndonjë gjykatë e Kosovës,
- c. askush nuk gjykohet para Dhomave të specializuara për vepra për të cilat ai veçse është gjykuar nga Tribunali ndërkombëtar për ndjekjen penale të personave përgjegjës për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare të kryera në territorin e ish Jugosllavisë që nga viti 1991 (“TPNJ”).

Neni 18 **Amnistia**

Juridiksioni i Dhomave të Specializuara nuk i nënshtrohet ndonjë lloji të amnistisë së lejuar sipas nenit 65(15) të Kushtetutës. Çdo amnistim dhënë personave për një krim ndërkombëtar, krime që kanë rezultuar në lëndime të rënda trupore apo vdekje, ose për një krim sipas nenit 14 (2), po që se bie brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, nuk do të jenë pengesë për ndjekje penale apo dënim.

KAPITULLI IV **RREGULLAT E PROCEDURËS DHE PROVAVE**

Neni 19 **Rregullat e procedurës dhe provave**

1. Rregullat e procedurës dhe provave për zhvillimin e procedurave para Dhomave të specializuara miratohen nga gjyqtarët e Dhomave të specializuara të cilët mblidhen në seancë plenare sa më parë që është e mundur pasi të emërohen dhe vendosen në regjistrin e gjyqtarëve ndërkombëtarë. Gjyqtarët e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese nuk marrin pjesë gjatë miratimit.
2. Rregullat e procedurës dhe provave i pasqyrojnë standardet më të larta të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) dhe Marrëveshjen Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (MNDCP), me synim garantimin e shqyrtimit gjyqësor të drejtë dhe të shpejtë, duke marrë parasysh natyrën, vendin dhe specifikat e procedurës që shqyrtohet nga Dhomat e specializuara. Në përcaktimin e Rregullave të Procedurës dhe Provave, Dhomat e Specializuara drejtohen nga Kodi i Procedurës Penale të Kosovës 2012, Ligji Nr, 04/L-123.

3. Rregullat e procedurës dhe provave janë në pajtim me këtë ligj, në veçanti me nenet 21-23 që i mbrojnë të drejtat e të akuzuarve, viktimave dhe dëshmitarëve. Për përfshirjen e të miturve, dëshmitarëve të cenusshëm dhe viktimave të dhunës seksuale dhe gjinore, merren masa të posaçme.

4. Rregullat e procedurës dhe provave mund të ndryshohen nga gjyqtarët e Dhomave në seancë plenare, në konsultim me prokurorin e specializuar dhe Administratorin e Dhomave të Specializuara, të cilët përfaqësojnë interesat e mbrojtjes dhe të viktimave. Zyra Administrative mund të konsultohet me organin e pavarur përfaqësues të Mbrojtësit të Specializuar për këtë qëllim.

5. Pas miratimit apo amendamentimit, Rregullat e miratuara apo amendamentimet e rregullave referohen tek Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, e cila i ka tridhjetë (30) ditë për t'i shqyrtuar rregullat apo amendamentimet për të siguruar përputhshmëri me kapitullin II, përfshirë nenin 55, të Kushtetutës. Në rast se Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese vërteton mospërputhshmëri me Kushtetutën, ai vërtetim i dërgohet gjyqtarëve në seancë plenare për të vepruar lidhur me dispozitën apo dispozitat e prekura. Gjyqtarët e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese nuk marrin pjesë gjatë këtij veprimi.

6. Dhomat e specializuara kanë kompetencë për të miratuar rregulla, politika dhe praktika të brendshme të cilat janë të nevojshme për funksionin e tyre të duhur, sigurinë apo drejtësinë e procedurës apo për t'i zbatuar dispozitat e këtij ligji.

Neni 20 Gjuhët zyrtare dhe të punës

Gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar janë gjuha shqipe, serbe dhe angleze. Pas marrjes së detyrës, Kryetari i Dhomave të Specializuara, Administratori, dhe Prokurori i Specializuar, secili përcaktojnë përdorimin zyrtar të gjuhës për ushtrimin e mandatit të tyre. Gjatë çdo procedure, gjyqtari i procedurës paraprake ose paneli mund të vendosin për gjuhën e punës gjatë procedurës, sipas nevojës dhe duke i respektuar në plotësi të drejtat e të akuzuarve.

Neni 21 Të drejtat e të akuzuarit

1. Të gjithë personat janë të barabartë para Dhomave të specializuara.

2. Në përcaktimin e akuzave kundër tij, i akuzuari gëzon të drejtën për seanca të drejta dhe publike, në pajtueshmëri me nenin 23 të këtij ligji dhe çdo mase të urdhëruar nga Dhomat e specializuara për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve.

3. I akuzuari konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij përtej dyshimit të arsyeshëm sipas dispozitave të këtij ligji.

4. Në përcaktimin e akuzave kundër të akuzuarit sipas këtij ligji, i akuzuari gëzon të drejtën e garancive minimale të mëposhtme, me barazi të plotë që:

- a. të njoftohet me kohë dhe në hollësi në gjuhën që ai e kupton për natyrën dhe shkaqet e akuzës kundër tij,
- b. të informohet me kohë për të drejtat e tij sipas ligjit,
- c. të ketë kohën dhe kushtet e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij dhe të komunikojë me Mbrojtësin e Specializuar të zgjedhur prej tij,
- d. të gjykohet brenda një kohe të arsyeshme,
- e. të gjykohet me praninë e tij, dhe të mbrohet përmes Mbrojtësit të Specializuar të zgjedhur prej tij; të informohet, nëse nuk ka ndihmë ligjore, për këtë të drejtë; dhe t'i caktohet Mbrojtës i Specializuar, në çdo rast kur kjo kërkohet për interesa të drejtësisë, dhe pa pagesë në rast se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për ta paguar,
- f. t'i merr në pyetje, ose t'i ketë marrë në pyetje, dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në emër të tij në kushte të njëjta me ato të dëshmitarëve kundër tij,
- g. të ketë ndihmën falas të përkthyesit, nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret në Dhomën e Specializuar dhe
- h. të mos detyrohet të dëshmojë kundër vetes apo të pranojë fajësinë.

5. I akuzuari nuk mund ta përfaqësojë veten pa përfaqësim ligjor (përfaqësim i detyruar) në rrethanat e paraqitura në vijim:

- a. në seancat për paraburgimin dhe gjatë kohës kur ai është në paraburgim,
- b. nga momenti i ngritjes së aktakuzës, në rast se kundër tij ngrihet aktakuzë për ndonjë krim që është i dënueshëm me së paku dhjetë (10) vite burgim dhe
- c. në të gjitha rastet kur i akuzuari kërkon të bëjë marrëveshje për pranimin e fajësisë për ndonjë krim që është i dënueshëm me burgim prej një (1) viti apo më shumë.

6. Të gjitha provat ose faktet materiale dhe relevante që i posedon Zyra e Prokurorit të Specializuar të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit vihen në dispozicion të të akuzuarit para fillimit të procedurës dhe gjatë saj, dhe i nënshtrohen vetëm atyre kufizimeve që janë rreptësisht të nevojshme dhe atëherë kur zbatohen mbrojtjet e nevojshme kundër-balancuese.

Neni 22

Të drejtat e viktimave

1. Viktimë është personi fizik i cili personalisht ka përjetuar dëm, përfshirë dëmet fizike, mendore ose materiale si rezultat i drejtpërdrejtë i ndonjë krimi brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara. Pjesëmarrja e viktimës në Dhomat e specializuara nuk përbënë ndalesë për dhënien e dëshmisë si dëshmitar para Dhomave të Specializuara.

2. Në rast se ndonjë viktimë nuk paraqet kërkesë për të marrë pjesë në procedurë në Dhomat e specializuara, apo nëse nuk është pranuar si pjesëmarrës apo nëse nuk është përcaktuar të jetë viktimë sipas këtij ligji, kjo nuk ia kufizon të drejtat e tij të parapara me ligjet e tjera ose përmes mekanizmave të tjerë të zhdëmtimit në Kosovë.

3. Interesi personal i viktimës dhe të drejtat e viktimës në procedurën penale para Dhomave të specializuara janë njoftimi, pranimi dhe zhdëmtimi. Rregullat e Procedurës dhe Provave të Dhomave të Specializuara përfshijnë dispozitat që kanë të bëjnë me zhdëmtimin e arsyeshëm të viktimave nga i akuzuari i cili e ka pranuar fajësinë apo që është gjykuar të jetë fajtor për ndonjë krim (krimet) që kanë rezultuar të jetë drejtpërdrejtë i dëmshëm për viktimat. Ato po ashtu përcaktojnë edhe përmbajtjen dhe procedurën për paraqitjen dhe pranimin e kërkesës për të marrë pjesë në procedurë dhe për të deklaruar dëmin.

4. Gjatë procesit të shqyrtimit gjyqësor, viktimat pjesëmarrëse formojnë një grup, përveç rasteve kur trupi gjykues urdhëron që ato duhet të ndahen në më shumë se një grup, përfshirë, nëse është e nevojshme, një grup për viktimat e dhunës seksuale dhe dhunës gjinore.

5. Grupet e viktimave ndihmohen dhe përfaqësohen nga mbrojtësi i viktimave, i siguruar përmes Zyrës për pjesëmarrjen e viktimave në Zyrën e regjistrimit. Asnjë përfaqësim tjetër i viktimave, përfshirë vet-përfaqësimin, nuk është i lejuar. Zyra për pjesëmarrjen e viktimave mund t'u sigurojë viktimave edhe këshilla dhe shërbime të tjera të lidhura me punën e Dhomave të specializuara, sipas nevojës.

6. Dhomat e specializuara mund të lejojnë përfaqësim nga mbrojtësi i viktimave në emër të viktimave gjatë procedurës paraprake dhe shqyrtimit gjyqësor, ashtu siç është e paraparë në rregullat e procedurës dhe provave, kur preken interesat personale të viktimave dhe vetëm kur një gjë e tillë nuk është paragjyqese ndaj të drejtave të akuzuarve apo nuk është në përputhje me të drejtat e të akuzuarve.

7. Në aktgjykimin e tij, trupi gjykues mundet që, në bazë të ndonjë kërkesë apo me propozim të vetin në rrethana të jashtëzakonshme, të përfshijë një vendim lidhur me shkallën dhe përmasat e dëmit, humbjes dhe lëndimeve ndaj viktimave, ose në lidhje me to, dhe i deklaron parimet sipas të cilave vepron. Nga ana tjetër, nëse një vendim i tillë do të zvarriste në mënyrë jo të duhur procedurën penale, trupi gjykues mund ta kufizojë vendimin e vet me identifikimin e viktimave të krimeve të vërtetuara në aktgjykimin e vet.

8. Kur trupi gjykues ose paneli i Gjykatës së Apelit të Dhomave të specializuara e gjykon të akuzuarin si fajtor për ndonjë krim, ai mund të nxjerrë urdhër drejtpërdrejt kundër personit të akuzuar, ku e specifikon zhdëmtimin e duhur ndaj viktimave, kolektivisht apo individualisht, ose në lidhje me ato viktime.

9. Kur është e nevojshme, Dhomat e specializuara mund t'i udhëzojnë viktimat që të ngrenë padi civile në gjykatat e tjera të Kosovës.

10. Kur trupi gjykues apo paneli i Gjykatës së Apelit të Dhomës së specializuar e gjykon të akuzuarin si fajtorë për ndonjë krim, me kërkesë të mbrojtësit të viktimave, Administratori i zyrës së regjistrimit mund t'u përcjellë autoriteteve kompetente të ndonjë shteti, apo drejtpërdrejtë viktimave, kopjen e vërtetuar të aktgjykimit ku i akuzuari gjykohet të jetë fajtor për ndonjë krim, dhe vendimin e tij për viktimat dhe, nëse është përfshirë, dëmin që u është shkaktuar viktimave.

11. Para marrjes së vendimit sipas këtij neni, trupi gjykues mund të ftojë dhe merr parasysh përfaqësimet në emër të akuzuarit, viktimave, personave të tjerë të interesuar, ose shteteve të interesuara.

Neni 23

Mbrojtja e Viktimave dhe e Dëshmitarëve

1. Rregullat Dhomave të specializuara për procedurën dhe provat e parashikojnë mbrojtjen e viktimave dhe të dëshmitarëve, përfshirë sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e tyre. Këto masa mbrojtëse i përfshijnë, por nuk limitohen, mjetet që janë të përcaktuara në nenet 221-226 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Ligji nr. 04/L-123, nenet 5-13 të Ligjit nr. 04/L-015 për mbrojtjen e dëshmitarëve, zhvillimin e procedurave *me dyer të mbyllura*, paraqitjen e provave me mjete elektronike ose mjete të tjera të veçanta, dhe mbrojtjen e identitetit.

2. Rregullat e procedurës dhe provave do të përfshijnë dispozita të posaçme për të garantuar mbrojtjen e dëshmitarëve të ndjeshëm, përfshirë viktimat e dhunës seksuale, viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe fëmijët. Këto masa mbrojtëse zbatohen gjatë procedurës në rastin e viktimave të dhunës seksuale dhe gjinore apo dëshmitarit/viktimës fëmijë. Gjyqtari apo paneli mund ti shmanget zbatimit të këtyre masave mbrojtëse vetëm për viktimat e dhunës seksuale dhe gjinore apo për ndonjë dëshmitar apo viktimë fëmijë pasi të jenë shqyrtuar me kujdes të gjitha rrethanat, në veçanti ato të viktimës, dhe pasi të jetë përcaktuar se ato masa nuk janë të nevojshme. Mbrojtësi i viktimave mund të bëjë përfaqësime para gjyqtarit të procedurës paraprake, panelit ose prokurorit të specializuar lidhur me masat e nevojshme mbrojtëse për viktimën që dëshmon para Dhomave të Specializuara.

3. Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve mund të bëjë përfaqësime para gjyqtarit të procedurës paraprake, panelit ose Prokurorit të specializuar lidhur me masat mbrojtëse, mekanizmat e sigurisë, këshillimin dhe asistencën e nevojshme për dëshmitarin para, gjatë dhe pas dëshmisë dhënë para Dhomave të Specializuara.

4. Dhomat e Specializuara, Zyra Administrative dhe Prokurori i specializuar mund të kërkojnë asistencë sipas nenit 32 të Ligjit nr. 04/L-015 për mbrojtjen e dëshmitarëve, ose përmes ndonjë modaliteti tjetër të paraparë me ligj, marrëveshjeve të bëra sipas nenit 3 apo marrëveshjeve ndërkombëtare.

KAPITULLI V

ORGANIZIMI, STRUKTURA DHE KOMPETENCAT

Neni 24

Organizimi i Dhomave të specializuara dhe i Prokurorisë së specializuar

1. Dhomat e Specializuara përbëhen nga këto organe:

- a. Dhomat, që përfshijnë Dhomën e Gjykatës Themelore, Dhomën e Gjykatës së Apelit, Dhomën e Gjykatës Supreme dhe Dhomën e Gjykatës Kushtetuese; dhe

- b. Zyrat Administrative, që përfshin Zyrën e mbrojtjes, Zyrën për pjesëmarrjen e viktimave, Zyrën për mbrojtjen dhe mbështetjen e dëshmitarëve, Njësinë e menaxhimit të paraburgimit, dhe një Zyrë të Ombudspersonit brenda strukturës së saj.
2. Zyra e Prokurorit të Specializuar, që do të marrë mandatin dhe personelin e Task Forcës Hetimore Speciale (“TFHS”), është zyrë e pavarur për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.

Neni 25

Përbërja e Dhomave

1. Në bazë të nenit 33, Dhomat kanë këtë përbërje:
 - a. Gjyqtarë individualë që sipas nevojës kryejnë detyrën e gjyqtarëve të procedurës paraprake,
 - b. Trupa gjykues të përbërë prej tre (3) gjyqtarëve dhe një (1) gjyqtari rezervë,
 - c. Panele të Gjykatës së Apelit të përbërë prej tre (3) gjyqtarëve,
 - d. Panele të Gjykatës Supreme të përbërë prej tre (3) gjyqtarëve;
 - e. Panele të Gjykatës Kushtetuese të përbërë prej tre (3) gjyqtarëve; dhe
 - f. Gjyqtarë individualë që sipas nevojës kryejnë detyra të tjera që kërkohen me këtë ligj;
2. Për procedurat në lidhje me nenin 15(2) krimet që nuk klasifikohen si krime të rënda sipas nenit 22 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Ligji nr. 04/L-123, trupi gjykues mund të përbëhet nga një gjyqtar i vetëm.
3. Rregullat për caktimin e gjyqtarëve të Dhomave të Specializuara nga regjistri i gjyqtarëve ndërkombëtarë miratohen nga gjyqtarët e Dhomave të Specializuara gjatë seancës plenare sa më shpejt të jetë e mundur pas emërimit të tyre dhe vendosjes së tyre në regjistër.

Neni 26

Regjistri i gjyqtarëve ndërkombëtarë

1. Regjistri i gjyqtarëve të pavarur ndërkombëtarë formohet në pajtueshmëri me procedurën e përcaktuar në nenin 28 (“Regjistri i gjyqtarëve ndërkombëtarë”).
2. Gjyqtarët janë të pranishëm në selinë e Dhomave të specializuara vetëm sipas nevojës me kërkesë të kryetarit, për të ushtruar funksionet që e kërkojnë praninë e tyre. Nëse është e mundur, dhe sipas vendimit të Kryetarit, funksionet mund të ushtrohen nga distanca.
3. Gjyqtarët nuk marrin pagesë ose përfitime të tjera, për listimin në regjistër.

4. Gjyqtarët në regjistrë bëjnë përpjekje që të mos ndërmarrin ndonjë veprimtari që mund ta komprometonte mundësinë e Kryetarit që t'i përzgjedhë ata për të ushtruar funksione si gjyqtar në Dhomat e specializuara.

5. Regjistri i gjyqtarëve ndërkombëtar përfshin tre gjyqtarë kushtetues që mund të caktohen për të shqyrtuar ndonjë referim për Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ('gjyqtarët e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese'), dhe një gjyqtar kushtetues rezervë.

Neni 27

Kualifikimet e gjyqtarëve të Dhomave të specializuara

1. Gjyqtarët e Dhomave të specializuara janë persona me moral të lartë, paanshmëri dhe integritet të cilët posedojnë kualifikime që kërkohen në shtetet e tyre përkatëse për t'u caktuar në detyrat më të larta gjyqësore. Ata janë të pavarur në përmbushjen e funksioneve të tyre dhe nuk pranojnë, as kërkojnë udhëzime nga ndonjë qeveri ose burim tjetër. Gjyqtarët e Dhomave të specializuara kanë aftësi të konsoliduara në fushën e të drejtës dhe procedurës penale ose në pjesët përkatëse të së drejtës ndërkombëtare, me përvojë të gjerë gjyqësore, prokuroriale, ose në mbrojtjen ligjore në procedurat penale ndërkombëtare ose vendore.

2. Në përbërjen e përgjithshme të regjistrit të gjyqtarëve ndërkombëtarë për Dhomat e specializuara, kujdes i duhur i kushtohet aftësive të konsoliduara dhe përvojës së gjyqtarëve në të drejtën dhe procedurën penale dhe të drejtën ndërkombëtare.

3. Gjyqtarët duhet të komunikojnë rrjedhshëm në gjuhën angleze.

Neni 28

Emërimi i gjyqtarëve

1. Një Panel i Pavarur Përzgjedhës ("Paneli Përzgjedhës") do të jetë përgjegjës për vlerësimin e kandidatëve dhe përzgjedhjen për emërimin e gjyqtarëve për regjistrin e gjyqtarëve ndërkombëtar, si dhe rekomandimet për emërimin e Kryetarit dhe Nënkyetarit të Dhomave të specializuara.

2. Paneli përzgjedhës përbëhet prej tre anëtarëve ndërkombëtarë, ku së paku dy anëtarë janë gjyqtarë ndërkombëtarë me përvojë të konsiderueshme ndërkombëtare në fushën penale. Një nga gjyqtarët ndërkombëtar shërben si anëtar kryesues i panelit.

3. Pasi t'i ketë shqyrtuar kandidatët e kualifikuar dhe t'i ketë intervistuar dhe vlerësuar kandidatët më të përshtatshëm, paneli përzgjedhës finalizon listën me emrat e kandidatëve që i rekomandon për pozitën e gjyqtarit në Dhomat e Specializuara. Paneli përzgjedhës merr vendimet, me shumicën e votave të anëtarëve të vet. Paneli përzgjedhës ia paraqet këtë listë Kreut të Misionit të BE-së për Siguri të Përbashkët dhe Mbrojtje ("Autoriteti Emërues") si rekomandime për emërimin e gjyqtarëve të Dhomave të specializuara në Regjistrin e Gjyqtarëve Ndërkombëtarë.

4. Rekomandimet e dhëna nga ndonjë panel përzgjedhës i formuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji nga ana e Autoritetit Emërues për këtë qëllim dhe në pajtim me këto parime gjithashtu mund të pranohen. Autoriteti Emërues i emëron personat nga lista e panelit përzgjedhës si gjyqtarë në Dhomat e specializuara dhe i vendosë ata në regjistër për aq kohë sa ekzistojnë Dhomat e specializuara.

Neni 29 **Vendet e lira në regjistër**

Numri i gjyqtarëve në regjistrin e gjyqtarëve ndërkombëtarë duhet të mbahet në atë nivel që e siguron funksionimin efikas dhe efektiv të Dhomave të specializuara. Në rast se numri i gjyqtarëve në regjistër bie nën këtë nivel, vendet e lira plotësohen me të njëjtën metodë që është përcaktuar nën 26-28 për emërimin e gjyqtarëve të Dhomave të specializuara dhe vendosjen e tyre në regjistër.

Neni 30 **Kompetencat dhe statusi i gjyqtarëve**

1. Gjyqtarët e Dhomave të specializuara kanë autoritet dhe përgjegjësi t'i kryejnë funksionet gjyqësore të parapara me këtë ligji për procedurat para Dhomave të specializuara për të cilat ata mund të caktohen dhe sipas modaliteteve të përcaktuara me këtë ligj.
2. Për veprimet e përcaktuara me këtë ligj të cilat kërkojnë vendimin e gjyqtarëve të Dhomave të specializuara nevojitet shumica absolute e gjyqtarëve të Dhomave të specializuara.
3. Kur gjyqtari caktohet nga regjistri për të marrë pjesë në ndonjë fazë të procedurës paraprake, shqyrtimit gjyqësor, gjykatës së apelit, gjykatës supreme të ndonjë rasti, në pajtim me nenin 33, ai gjyqtar caktohet për një mandat katërvjeçar ose deri në përfundimin e fazës së procedurës në të cilën është caktuar, në rast se ajo fazë përfundon më herët.
4. Kryetari emërohet për mandat katërvjeçar, mandati i të cilit mund të ripërtërihet.
5. Me përjashtim të Kryetarit, gjyqtarët të cilët shërbejnë në Dhomat e specializuara gëzojnë status dhe kushte shërbimi të barabarta gjatë kohës që janë të angazhuar në punën e Dhomave të specializuara.
6. Termat dhe kushtet e shërbimit të gjyqtarëve për çdo ditë që ata i ushtrojnë funksionet e tyre për Dhomat e specializuara janë në pajtim me nenin 29(5) dhe standardet ndërkombëtare për pavarësinë.

Neni 31 **Pavarësia e gjyqtarëve**

1. Gjyqtarët e Dhomave të specializuara janë të pavarur në kryerjen e funksioneve të tyre. Ata marrin pjesë në shqyrtimet para Dhomave të specializuara në kapacitet individual.

2. Të përzgjedhur nga regjistri apo jo, gjyqtarët nuk angazhohen në asnjë veprimtari që ka mundësi të ndërhyjë në funksionet gjyqësore të tyre, apo të cenojë besimin në pavarësinë e tyre.
3. Kur gjyqtarët caktohen sipas nenit 30 (3), ata nuk angazhohen në asnjë punësim tjetër të natyrës profesionale.
4. Asnjë gjyqtar nuk mund të përjashtohet përveç nëse gjyqtarët e tjerë, me shumicë absolute, vërtetojnë se ai nuk i plotëson më kushtet e parapara nën nenet 27 dhe 31. Kur një çështje e tillë ka të bëjë me ndonjë gjyqtar individual, ai gjyqtar nuk merr pjesë në vendimmarrje.

Neni 32

Emërimi dhe Funksionet e Kryetarit dhe Nënkyetarit

1. Bazuar në rekomandimin e panelit përzgjedhës, Autoriteti Emërues emëron Kryetarin dhe Nënkyetarin nga radhët e gjyqtarëve të Dhomave të specializuara, i cili shërben me orar të plotë. Kryetari e kryeson çdo panel të Gjykatës Supreme ku ai është anëtar.
2. Në rast se posti i Kryetarit mbetet i lirë, Kryetari i ri zgjidhet me shumicën absolute të gjyqtarëve të Dhomave të specializuara nga radhët e gjyqtarëve të Dhomave të specializuara.
3. Kryetari është përgjegjës për administrimin gjyqësor të Dhomave të Specializuara dhe për funksionet e tjera që i ngarkohen atij me këtë ligj.
4. Në bazë të rekomandimit të Panelit Përzgjedhës, Autoriteti Emërues gjithashtu emëron një Nënkyetar të Dhomave të Specializuara nga radhët e gjyqtarëve të Dhomave të Specializuara. Nënkyetari do të aktivizohet nga regjistri dhe do të marrë përsipër detyrat e Kryetarit të Dhomave të Specializuara në mungesë të këtij të fundit apo nga pamundësia e tij/saj për të vepruar. Nënkyetari i Dhomave të Specializuara është gjithashtu përgjegjës për funksione tjera që i ngarkohen atij ose asaj me këtë ligj. Po që se posti i nënkyetarit mbetet vakant, një nënkyetar i ri i Dhomave të Specializuara zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve të Dhomave të Specializuara me shumicë absolute të gjyqtarëve të Dhomave të Specializuara.

Neni 33

Caktimi i gjyqtarëve dhe përbërja e paneleve

1. Kryetari i cakton gjyqtarët nga Regjistri në pajtim me rregullat për caktimin e gjyqtarëve të Dhomave të specializuara të miratuara sipas nenit 25(3), si më poshtë:
 - a. Me ngritjen e aktakuzës sipas nenit 38(4), caktohet gjyqtari për kryerjen e funksioneve të gjyqarit të procedurës paraprake ashtu siç është e përcaktuar në nenin 39. Caktimi i gjyqtarit të procedurës paraprake përfundon tridhjetë (30) ditë pasi të jetë formuar trupi gjykues, përveç nëse gjyqtari i procedurës paraprake është i përfshirë në ndonjë procedurë që pritet të zgjasë më shumë se tridhjetë (30) ditë, ku caktimi i tij përfundon në kohën e përmbylljes së asaj procedure.

- b. Trupi gjykues, përfshirë gjyqtarin rezervë, apo trupin gjykues me një gjyqtar të vetëm për rastet e parapara nën nenin 25(2), caktohet sapo të jetë vendosur rreth ndonjë parashtrese fillestare, përfshirë ankesat kundër formës së aktakuzës dhe juridiksionit, dhe kur rasti është i gatshëm për shqyrtim gjyqësor, por jo më vonë se 30 ditë para datës së caktuar për fillimin e shqyrtimit gjyqësor, ose kur ndonjë çështje i është kthyer trupit gjykues për rishqyrtim gjyqësor. Caktimi i gjyqtarit (gjyqtarëve) të trupit gjykues përfundon në ditën kur formohet paneli i Gjykatës së Apelit për të dëgjuar ankesën kundër aktgjykimit të tij apo nëse periudha kohore për ankesë skadon pa u paraqitur asnjë ankesë, përveç nëse trupi gjykues është njëkohësisht i përfshirë në procedura të tjera, me ç'rast caktimet e gjyqtarëve përfundojnë në kohën e përmbylljes të atyre procedurave.
- c. Paneli i Gjykatës së Apelit, sapo të paraqitet parashtresa për ankesë të ndërmjetme në lidhje me ndonjë vendim të gjyqtarit të procedurës paraprake ose të trupit gjykues sipas së drejtës nga neni 45(1), jepet leja për ankesë të ndërmjetme jepet sipas nenit 45(2) apo parashtrohet njoftimi për ankesë në lidhje me ndonjë aktgjykim të trupit gjykues sipas nenin 46. Caktimet e gjyqtarëve të Panelit të Gjykatës së Apelit përfundojnë në ditën pasi Paneli i Gjykatës së Apelit të ketë shqiptuar aktgjykimin e tij, përveç rastit kur Paneli i Gjykatës së Apelit është njëkohësisht përfshirë në procedura të tjera, me ç'rast caktimi i gjyqtarëve përfundon në kohën e përmbylljes së atyre procedurave.
- d. Paneli i Gjykatës Supreme sapo të jetë paraqitur njoftimi për ankesë nga ndonjë aktgjykim i shkallës së dytë nga ana e Panelit të Gjykatës së Apelit, ose kërkesa për mjete ligjore të jashtëzakonshme, në pajtim me nenet 47 dhe 48 përkatësisht. Caktimi i gjyqtarëve të Panelit të Gjykatës Supreme përfundon në ditën pasi Paneli i Gjykatës Supreme të ketë shqiptuar aktgjykimin e tij, përveç rastit kur Paneli i Gjykatës Supreme është i përfshirë në të njëjtën kohë në procedura të tjera, në të cilin rast caktimi i gjyqtarëve përfundon kur të jenë përmbyllur ato procedura.

2. Pavarësisht paragrafit 1, Kryetari gjithashtu mund të caktojë një gjyqtar të vetëm nga regjistri në pajtim me rregullat për caktimin e gjyqtarëve, të miratuara sipas nenit 25(3) për t'u marrë me ndonjë çështje që, sipas mendimit të Kryetarit, kërkon caktimin e një gjyqtari dhe jo të gjyqtarit të procedurës paraprake. Caktimet sipas këtij paragrafi janë të natyrës së përkohshme dhe pushojnë sapo të jetë zgjidhur çështja për të cilën janë bërë ato caktime.

3. Me pranimin e referimeve në Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Dhomave të Specializuara do të caktojë tre gjyqtarë të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese të veprojë si Panel i Gjykatës Kushtetuese. Nëse njëri prej këtyre gjyqtarëve nuk është në dispozicion për marrje të detyrës, Kryetari i Dhomave të Specializuara cakton një gjyqtar kushtetues rezervë. Funkzioni i Panelit të Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese përfundon në ditën pasi që Paneli i Gjykatës Kushtetuese nxjerr vendim/mendim, përveç nëse Paneli i Gjykatës Kushtetuese është i përfshirë njëkohësisht në procedura tjera, në të cilin rast funksioni i gjyqtarëve përfundon kur këto procedura të jenë përfunduar.

4. Kur ndonjë gjyqtar caktohet si gjyqtar i procedurës paraprake apo anëtar i ndonjë paneli për ndonjë çështje, ai nuk mund të jetë anëtar i ndonjë paneli tjetër në një fazë tjetër të së njëjtës çështjeje.

5. Në rast të shkeljes së nenit 15(2) të këtij ligji gjatë kohës kur ndonjë gjyqtar është në shqyrtim të ndonjë çështjeje, ai gjyqtar përjashtohet nga procedurat penale që rezultojnë nga ajo shkelje. Gjyqtari vazhdon angazhimin në cilësinë e tij fillestare në procedurën penale fillestare.

6. Kryetari i Dhomave të Specializuara është kryetar i trupit gjykues të çdo Paneli të Gjykatës Supreme në të cilin ai merr pjesë. Kur Kryetari përjashtohet nga shqyrtimi i ndonjë çështjeje, ose ka arsye të tjera të vlefshme për të mos marrë pjesë në ndonjë Panel të Gjykatës Supreme për ndonjë rast të caktuar, kryetari cakton një gjyqtar në pajtim me rregullat për caktimin e gjyqtarëve të Dhomave të specializuara të miratuara sipas nenit 25(2) për ta zëvendësuar në atë panel. Në këtë rast, gjyqtarët e Panelit të Gjykatës Supreme zgjedhin me votim kryetarin e panelit nga radhët e tyre.

7. Kur caktohet trupi gjykues ose Paneli i Gjykatës së Apelit, gjyqtarët e atij paneli e zgjedhin me votim kryetarin e trupit gjykues nga radhët e tyre.

8. Ligji nr. 03/L-053 për juridiksionin dhe kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat dhe çdo rregullore tjetër e ndërlikur, nuk zbatohen për lëndët para Dhomave të specializuara. Ligji për Gjykatën Kushtetuese, Ligji nr. 03/L-121 dhe Rregullat e Procedurës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nuk zbatohen për referime kushtetuese para Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 34 **Zyra Administrative**

1. Zyra Administrative është përgjegjëse për administrimin dhe shërbimin e Dhomave të Specializuara, si dhe për të gjitha funksionet e nevojshme përkatëse.

2. Zyra Administrative përbëhet nga Administratori i Dhomave të Specializuara (Administratori) zyrës dhe stafi tjetër që nevojitet.

3. Administratori është përgjegjës për administrimin e Dhomave të Specializuara dhe mund tëë lëshojë rregulla tëë brendshme dhe udhëzime tëë nevojshme për këëtëë qëllim. Administratori është i pavarur në ushtrimin e detyrave të tij.

4. Administratori emërohet nga Autoriteti Emërues pas vlerësimit të kandidatëve me kualifikime të duhura. Administratori ka karakter me moral të lartë, është tejet kompetent në administrimin e gjykatave.

5. Administratori shërben për një mandat katërvjeçar dhe gëzon të drejtën e riemërimit. Termat dhe kushtet e shërbimit të administratorit janë në nivel të krahasueshëm me ato të Kryetarit dhe Prokurorit të Specializuar.

6. Zyra Administrative përmban brenda vetes Zyrën për pjesëmarrjen e viktimave, e cila e administron sistemin e pjesëmarrjes së viktimave sipas nenit 22 dhe Rregullat e procedurës dhe provave, listën e avokatëve të viktimave si dhe sistemin e pagesës për përfaqësimin e viktimave, si dhe u ofron asistencë dhe këshilla në lidhje me procedurat penale viktimave të cilat marrin pjesë në procedurat para Dhomave të Specializuara.

7. Zyra Administrative përmban brenda vetes Zyrën e Mbrojtjes, që në emër të Administratorit e administron listën e mbrojtësve të cilët kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre para Dhomave të specializuara (“Mbrojtësi i specializuar”), si dhe sistemin e ndihmës ligjore për përfaqësimin para Dhomave të specializuara të akuzuarve që nuk kanë mundësi apo që kanë mundësi të pjesshme për pagesë. Ligji nr. 04/L-193 për avokatinë dhe Ligji nr. 04/L-017 për ndihmën juridike falas dhe çdo dispozitë, rregull, rregullore ose tarifë tjetër që ndërlidhet me to, nuk zbatohen për Dhomat e Specializuara.

8. Zyra Administrative përmban brenda vetes Zyrën për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve, e cila, në emër të Administratorit, në konsultim me Prokurorinë e specializuar, Mbrojtësin e specializuar ose Mbrojtësin e viktimave kur është e nevojshme, zbaton masa mbrojtëse të urdhëruara nga gjykata apo masat e tjera mbrojtëse të nevojshme dhe aranzhimet e sigurisë, këshillim dhe asistencën tjetër të nevojshme për dëshmitarët dhe personat e tjerë të cilët janë të rrezikuar për shkak të dëshmisë së dhënë nga dëshmitarët.

9. Zyra Administrative përmban brenda vetes Zyrën e Ombudspersonit, e cila e kryen detyrën e Ombudspersonit e Dhomave të Specializuara me përgjegjësi ekskluzive për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar sipas Amendamentit nr 24 të Kushtetutës. Ligji për Ombudspersonin, Ligji nr. 03/L-195, nuk zbatohet për punën e Dhomave të Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Ombudspersoni do të emërohet nga Autoriteti Emërues pas shqyrtimit të aplikantëve të kualifikuar. Ombudspersoni ka karakter të lartë moral dhe është kompetent në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut. Roli dhe funksioni i Ombudspersonit të Dhomave të specializuara rregullohet në Rregullat e procedurës dhe provave. Ombudspersoni i Dhomave të specializuara mund t’i jap rekomandime Kryetarit të Dhomave të Specializuara ose Zyrës së Prokurorit të Specializuar sipas nenit 135(3) të Kushtetutës dhe mund të bëjë referime për tek Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenet 113(2) dhe 135(4) të Kushtetutës dhe nenin 49 të këtij ligji.

10. Zyra Administrative përmban zyrtarët e gjykatës dhe po ashtu mund të mbështetet edhe në asistencën e policisë në Kosovë, për zbatimin e urdhrave ose për dorëzimin e dokumenteve në emër të Dhomave të Specializuara. Zyrtarët e Gjykatës së Dhomave të Specializuara kanë autoritetin dhe përgjegjësinë të ushtrojnë kompetencat që i janë dhënë Policisë së Kosovës sipas ligjit të Kosovës, në pajtim me modalitetet e përcaktuara me këtë ligj.

11. Zyra Administrative përmban një Zyrtar për Mbrojtjen e të Dhënave i cili monitoron përputhshmërinë me nenin 35(4) të Kushtetutës. Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave po ashtu udhëhiqet nga standardet e BE-së për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale.

12. Administratori po ashtu është përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e funksionimit dhe ambienteve të paraburgimit për Dhomat e Specializuara, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me këtë ligj. Zyrtarët korrektues/të paraburgimit të Dhomave të Specializuara kanë autoritetin dhe përgjegjësinë për të ushtruar kompetencat që u janë dhënë zyrtarëve korrektues të Kosovës sipas legjislacionit të Kosovës dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara me këtë ligj.

Neni 35

Prokurori i Specializuar

1. Prokurori i specializuar është përgjegjës për hetimin dhe ndjekjen penale të personave përgjegjës për krimet që përfshihen brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe është i pavarur në kryerjen e detyrave të veta.

2. Prokurori i Specializuar dhe prokurorët e tjerë në Zyrën e Prokurorit të Specializuar kanë autoritetin dhe përgjegjësinë për t'i kryer funksionet e detyrës së tij/saj, përfshirë autoritetin për të zhvilluar hetime penale dhe për të marrë përgjegjësi për hetimet penale apo procedurat gjyqësore të reja apo në proces në kuadër të juridiksionit lëndor të Dhomave të Specializuara dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara me këtë ligj. Këto autoritete dhe përgjegjësi përfshijnë:

- a. bërjen e kërkesës për praninë dhe marrjen në pyetje të dyshuarve, viktimave dhe dëshmitarëve, si dhe nëse është e nevojshme thirrjen e këtyre personave;
- b. grumbullimin dhe ekzaminimin e informacionit dhe provave;
- c. kryerjen e hetimeve në vendngjarje;
- d. kërkimin e bashkëpunimit të ndonjë shteti ose organizate ndërqeveritare, ndërkombëtare ose kombëtare në pajtim me kompetencën ose mandatin e tij, dhe bërjen e çdo aranzhimi apo lidhjen e çdo marrëveshjeje që mund të jetë e nevojshme në atë drejtim;
- e. pa paragjykuar të drejtat e të akuzuarit sipas nenit 21 (6), pajtimin që informatat që prokurori i merr me kusht të konfidencialitetit dhe vetëm për qëllimin e gjetjes së provave të reja të mos i bëjë publike gjatë asnjë faze të procedurës, përveç rastit kur ofruesi i informatave e jep pëlqimin e tij;
- f. marrjen e masave të nevojshme, ose bërjen e kërkesës për marrjen e masave të nevojshme për ta siguruar konfidencialitetin e informatave, mbrojtjen e çdo personi ose ruajtjen e provave;
- g. marrjen e vendimeve për fillimin, vazhdimin ose pushimin e procedurës penale brenda juridiksionit lëndor të Dhomave të Specializuara;
- h. urdhërimin e arrestimit të ndonjë personi gjatë fazës hetimore për një periudhë kohore prej jo më gjatë se dyzet e tetë (48) orë me arsyet e përcaktuara në nenin 41(6) dhe në pajtueshmëri me nenin 41 në përgjithësi, dispozitat e tjera përkatëse të këtij ligji dhe Rregulloren e procedurës dhe provave;
- i. ngritjen e aktakuzave dhe ndjekjen e tyre nëpër të gjitha fazat para Dhomave të specializuara, përfshirë dhënien e përgjigjes për çdo kërkesë në Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese;
- j. ushtrimin e të gjitha të drejtave ankimore të përcaktuara në këtë ligj;

- k. bashkëpunimin me policinë, Zyrën e regjistrimit, Dhomat e specializuara dhe panelet, institucionet dhe subjektet e tjera të Kosovës, shtetet, organizatat ndërkombëtare dhe subjektet e tjera dhe;
 - l. ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme që i kërkohen prokurorit të specializuar sipas këtij ligji.
3. Policia në kuadër të Zyrës së Prokurorit të Specializuar e ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të ushtruar kompetencat që i janë dhënë Policisë së Kosovës sipas ligjeve të Kosovës, në pajtim me modalitetet e përcaktuara me këtë ligj, duke përfshirë ato, por jo vetëm, në nenin 70(3) të Kodit të Procedurës Penale, Ligji nr. 04/L-123.
4. Në përmbushjen e këtyre detyrave, Prokurori i Specializuar dhe stafi i tij/saj ndihmohen, sipas nevojës, nga autoritetet, subjektet dhe personat e Kosovës, si dhe nga shtetet dhe subjektet që bien dakord të bashkëpunojnë dhe të ndihmojnë.
5. Zyra e Prokurorit të Specializuar vepron e pavarur nga Dhomat e Specializuara dhe autoritetet e tjera të prokurorisë në Kosovë. Prokurori i Specializuar dhe të gjithë anëtarët e stafit të Prokurorisë së specializuar nuk kërkojnë e as nuk marrin udhëzime nga asnjë qeveri apo burim tjetër. Prokurori i Specializuar nuk angazhohet në ndonjë veprimtari që ka mundësi të ndërhyjë në funksionet e tij/saj prokuroriale, ose të ndikojë në besimin për pavarësinë e tij/saj. Ai ose ajo nuk angazhohet në asnjë punësim tjetër të natyrës profesionale.
6. Me themelimin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, Kryeprokurori i TFHS emërohet si Prokuror i Specializuar nga Autoriteti Emërues.
7. Kurdo që Prokurori i Specializuar e lë bosh pozitën e tij/saj, Autoriteti Emërues e emëron zëvendësuesin e tij/saj, pas vlerësimit të kandidatëve me kualifikimet e duhura. Prokurori i Specializuar ka karakter me moral të lartë dhe zotëron nivelin më të lartë të aftësive dhe përvojës për zhvillimin e hetimeve dhe ndjekjeve penale të rasteve penale.
8. Prokurori i Specializuar shërben për një mandat katërvjeçar dhe gëzon të drejtën e riemërimit. Termat dhe kushtet e shërbimit të prokurorit janë në nivel të krahasueshëm me atë të Kryetarit të Dhomave të Specializuara apo Administratorit të Zyrës së Regjistrimit.
9. Zyra e Prokurorit të Specializuar përbëhet nga Prokurori i Specializuar, prokurorë të tjerë, policia dhe stafi tjetër i kualifikuar, siç mund të kërkohet. Prokurorët dhe zyrtarët e tjerë emërohen nga Autoriteti Emërues me rekomandim të Prokurorit të Specializuar.
10. Për të siguruar vazhdimësinë e hetimit, TFHS bartet nga pozicioni i tanishëm brenda Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) në Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Të gjitha njohjet, privilegjet, bashkëpunimi, marrëveshjet dhe aranzhimet me TFHS vazhdojnë edhe pas kësaj bartjeje dhe vlejné për Zyrën e Prokurorit të Specializuar.
11. Zyra e Prokurorit të Specializuar e ka selinë në shtetin pranues dhe mund t'i ushtrojë kompetencat dhe funksionet e saj në Kosovë, në shtetin pranues dhe në çdo shtet tjetër që bie dakord për atë.

Neni 36
Deklarata solemne

Para se t'i marrin përsipër detyrat e tyre sipas këtij ligj, Kryetari i Dhomave të Specializuara, Gjyqtarët, Prokurori i Specializuar dhe Administratori i Zyrës së Regjistrimit japin nga një deklaratë/zotim solemn se do t'i ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe me ndërgjegje.

KAPITULLI VI
ZHVILLIMI I PROCEDURAVE PARA DHOMAVE TË SPECIALIZUARA

Neni 37
Provat e Mbledhura Para Themelimit të Dhomave të Specializuara

1. Provat që janë mbledhur gjatë procedurave ose hetimeve penale brenda juridiksionit lëndor të Dhomave të Specializuara para themelimit të tyre nga ndonjë autoritet ose agjenci kombëtare ose ndërkombëtare për zbatimin e ligjit ose për zhvillimin e hetimeve penale, përfshirë Prokurorin e Shtetit të Kosovës, nga autoritetet policore në Kosovë, nga TPNJ, EULEX Kosova ose nga TFHS mund të jenë të pranueshme para Dhomave të Specializuara. Pranueshmëria e tyre vendoset nga panelet e caktuara në pajtim me standardet ndërkombëtare për mbledhjen e provave dhe nenin 22 të Kushtetutës. Pesha që do t'i jepet çdo prove të tillë përcaktohet nga panelet e caktuara.

2. Në parim, të gjitha dëshmitë duhet të prezantohen në prani të të akuzuarit me qëllim të kundër argumentimit. Përgjashtimet mund të përcaktohen në Rregullat e Procedurës dhe Provave të miratuara në pajtim me nenin 19, në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut.

3. Duke iu nënshtuar përcaktimit gjyqësor për pranueshmërinë dhe peshën sipas paragrafit 1 dhe 2,

a. transkriptet e dëshmime të dëshmitarëve të dhëna para Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) dhe procesverbalet e deklaratave të dëshmitarëve të bëra para TPNJ-së në pajtim me Rregullën 71 të Rregullave për Procedurën dhe Provat të TPNJ-së mund të jenë të pranueshme para Dhomave të Specializuara, me kusht që dëshmia ose deklaratat të jenë përkatëse për ndonjë fakt në fjalë në procedurën para Dhomave të Specializuara,

b. transkriptet e dëshmime të dëshmitarëve të dhëna para ndonjë gjykate të Kosovës, përfshirë dëshmitë në procedurën paraprake ose dëshmitë e ruajtura si pjesë e një Mundësie Hetimore të Veçantë sipas cilitdo kod të procedurës penale të zbatueshëm në Kosovë në kohën përkatëse, mund të jenë të pranueshme para Dhomave të Specializuara, pavarësisht asaj nëse gjyqtarët që janë pjesë e panelit e kanë dëgjuar dëshminë fillestare ose jo,

c. dokumentet origjinale, kopjet e vërtetuara, kopjet elektronike të vërtetuara dhe kopjet e vërtetuara si të pandryshuara në krahasim me origjinalet e tyre, si dhe provat mjeko-

ligjore të mbledhura nga cilido autoritetet i paraqitur në paragrafin 1 mund të jenë të pranueshme në procedurat para Dhomave të Specializuara; dhe

d. raporti ose deklarata e ndonjë dëshmitari ekspert, e pranuar si provë në TPNJ, ose dëshmia e ndonjë eksperti para TPNJ-së mund të jenë të pranueshme para Dhomave të Specializuara, si kur eksperti është i pranishëm, ashtu dhe kur ai nuk është i pranishëm për të dhënë dëshmi me gojë para Dhomave të Specializuara.

4. Trupi gjykues nuk kërkon të dëshmohen faktet që janë të ditura përgjithësisht, por i merr ato parasysh në bazë gjyqësore.

5. Me rastin e vendosjes rreth relevancës ose pranueshmërisë së provave të mbledhura nga ndonjë shtet ose autoritet shtetëror tjetër përveç Kosovës apo autoriteteve të saj, Dhomat e Specializuara nuk vendosin lidhur me zbatimin e së drejtës vendore të atij shteti tjetër.

Neni 38

Hetimet dhe përgatitja e aktakuzës

1. Prokurori i Specializuar, prokurorët e tjerë dhe policia në Zyrën e Prokurorit të Specializuar kanë kompetencë që të zhvillojnë hetime kundër personave penalisht përgjegjës për veprat penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.

2. Prokurori i Specializuar, prokurorët e tjerë dhe policia nga Prokuroria e specializuar kanë kompetencë që t'i marrin në pyetje të dyshuarit, viktimat dhe dëshmitarët e mundshëm, të mbledhin prova, të zhvillojnë hetime në vendngjarje, si dhe të urdhërojnë arrestimin e ndonjë personi për jo më gjatë se 48 orë sipas nenit 41. Në realizimin e këtyre detyrave, Prokurori i specializuar mund, sipas nevojës, të kërkojë asistencën e autoriteteve shtetërore nga nenet 53-55 dhe nëse është e nevojshme përmes aranzhimeve të bëra sipas nenit 4.

3. Nëse merret në pyetje, i dyshuari nuk detyrohet të fajësojë veten apo të pranojë fajësinë. I dyshuari nuk i nënshtrohet asnjë forme të shtrëngimit, trysnisë apo kërcënimit, torturës apo asnjë forme tjetër të trajtimit apo ndëshkimit mizor, çnjerëzor dhe degradues. Ai ose ajo ka këto të drejta, për të cilat ai informohet para marrjes në pyetje, në gjuhën që ai e flet dhe e kupton:

- a. të drejtën për t'u informuar se ekzistojnë arsye për të besuar se ai ka kryer ndonjë krim brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara,
- b. të drejtën për të heshtur, ku kjo heshtje nuk merret parasysh për përcaktimin e fajësisë ose të pafajësisë, dhe për t'u paralajmëruar se çdo deklaratë që ai e jep regjistrohet dhe mund të përdoret si provë
- c. të drejtën për t'u ndihmuar nga Mbrojtësi i Specializuar i zgjedhur prej tij/saj dhe për t'u marrë në pyetje në prani të Mbrojtësit të Specializuar, përfshirë të drejtën për të pasur ndihmën ligjore falas të ofruar nga Dhomat e Specializuara kur ai ose ajo nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar,

- d. të drejtën për të pasur ndihmën falas të një përkthyesi, kur ai nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e përdorur gjatë marrjes në pyetje.

4. Me të përcaktuar se ekziston dyshimi i bazuar mirë se ndonjë person ka përgjegjësi penale për ndonjë vepër brenda juridiksionit të Dhomave të specializuara, prokurori i specializuar e përgatitë aktakuzën që përmban deklaratën e përpiktë të fakteve dhe krimin ose krimet për të cilat akuzohet ai person sipas këtij ligji. Aktakuza parashtrohet në Dhomat e specializuara së bashku me materialin mbështetës.

Neni 39

Kompetencat dhe funksionet e Gjyqtarit të Procedurës Paraprake

1. Gjyqtari i procedurës paraprake ka kompetencë për ta shqyrtuar aktakuzën, për të vendosur lidhur me parashtrësit paraprake, përfshirë ankesat ndaj aktakuzës dhe juridiksionit, si dhe që të nxjerrë urdhër apo vendim të nevojshëm për të siguruar që rasti të përgatitet siç duhet dhe në mënyrë të shpejtë për gjykim.

2. Gjyqtari i procedurës paraprake e shqyrton aktakuzën. Kur është i bindur se prokurori i specializuar e ka përcaktuar ekzistimin e dyshimit të bazuar mirë, gjyqtari i procedurës paraprake e konfirmon aktakuzën. Kur nuk është aq i bindur, aktakuza ose akuzat që ajo i përmban hedhen poshtë. Prokurori i specializuar nuk përjashtohet nga kërkesa pasuese për konfirmimin e aktakuzës nëse kërkesa mbështetet me prova shtesë.

3. Me kërkesë të Prokurorit të Specializuar, gjyqtari i procedurës paraprake mund të lëshojë urdhërarrestim apo fletarrestim dhe të urdhërojë transferimin e personave në Dhomat e specializuara, si dhe çfarëdo urdhri tjetër që mund të kërkohej për zhvillimin e hetimeve dhe për përgatitjen e shqyrtimit gjyqësor të drejtë dhe të shpejtë, përfshirë urdhrat që kanë të bëjnë me mundësinë e veçantë hetimore dhe masat e posaçme hetimore.

4. Në zbatim të urdhërarrestit ose fletarrestimit të lëshuar nga Dhomat e specializuara, personi kundër të cilit është konfirmuar aktakuza merret në ndalim (nëse nuk është në paraburgim), informohet menjëherë për akuzat kundër tij dhe transferohet në Dhomat e Specializuara. Nëse nuk është lëshuar fletarrestimi dhe nëse është në liri, i akuzuari thirret për t'u paraqitur personalisht ose përmes videolidhjes në shqyrtimin fillestar para Dhomave të Specializuara.

5. Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i procedurës paraprake e lexon aktakuzën, bindet se të drejtat e të akuzuarit janë respektuar, konfirmon se i akuzuari e kupton aktakuzën dhe e udhëzon të akuzuarin që të bëjë marrëveshje për pranimin e fajësisë. Gjyqtari i procedurës paraprake siguron që materiali në mbështetje të aktakuzës i është dhënë apo i jepet të akuzuarit në gjuhën që i akuzuari e kupton.

6. Seancat janë publike, përveç nëse gjyqtari i procedurës paraprake vendosë ta zhvillojë seancën me dyer të mbyllura sipas Rregullave të Procedurës dhe Provave.

7. Në pajtim me nenin 20, gjyqtari i procedurës paraprake mund të përcaktojë gjuhën apo gjuhët e punës që përdoren gjatë zhvillimit të procedurës, përfshirë për fazën e shqyrtimit gjyqësor për të ndihmuar në përgatitjet efikase.

8. Pasi të jetë konfirmuar aktakuza por para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor, Prokurori i specializuar mundet ta ndryshojë aktakuzën me lejen e gjyqtarit të procedurës paraprake (ose të trupit gjykues nëse është i informuar) pasi t'i ketë dëgjuar palët. Nëse Prokurori i specializuar kërkon të shtojë akuza të tjera, apo t'i zëvendësojë akuzat më të rënda, gjyqtari i procedurës paraprake i shqyrton ato akuza dhe e mban shqyrtimin fillestar në pajtim me këtë nen.

9. Me kërkesë të palëve ose pas njoftimit të palëve, gjyqtari i procedurës paraprake (ose trupi gjykues nëse është i informuar) mund të udhëzojë bashkimin ose ndarjen e lëndëve në lidhje në rastin e akuzave kundër më shumë se një të akuzuari.

10. Me kërkesë të arrestuarit ose të personit që paraqitet në përgjigje të fletë-thirrjes, gjyqtari i procedurës paraprake mund të nxjerrë urdhra që mund të jenë të nevojshëm për ta ndihmuar atë person të përgatisë mbrojtjen e tij.

11. Kur është e nevojshme, gjyqtari i procedurës paraprake mund të sigurojë mbrojtjen dhe privatësinë e viktimave dhe të dëshmitarëve, ruajtjen e provave, mbrojtjen e personave dhe informacionit të sigurisë kombëtare ose ruajtjen e pasurive që mund të jenë objekt i sekuestrimit sipas këtij ligji dhe Rregullave të procedurës dhe provave, përfshirë urdhrat për ngrirje të përkohshme, urdhrat për konfiskim të përkohshëm ose masat e tjera të përkohshme.

12. Kur është e nevojshme, gjyqtari i procedurës paraprake mund të kërkojë bashkëpunimin e shteteve ose të organizatave ndërqeveritare, ndërkombëtare ose kombëtare, i cili bashkëpunim mund të jetë i nevojshëm për cilindo nga këto qëllime.

13. Kur është e nevojshme, me kërkesë të palës apo mbrojtësit të viktimave ose me vetë kërkesën e tij, gjyqtari i procedurës paraprake mund të nxjerrë ndonjë urdhër tjetër që mund të jetë i nevojshëm për përgatitjen e shqyrtimit gjyqësor të drejtë dhe të shpejtë.

Neni 40 **Kompetencat dhe Funksonet e Trupit Gjykues**

1. Pas shqyrtimit fillestar dhe sapo të jetë zgjidhur çdo parashtresë paraprake, përfshirë ankesat ndaj formës së aktakuzës dhe juridiksionit dhe pasi që gjyqtari i procedurës paraprake të ketë përcaktuar se rasti është i gatshëm për shqyrtim gjyqësor, Kryetari, në pajtim me rregullat për caktimin e gjyqtarëve, të miratuara sipas nenit 25 (2), e formon trupin gjykues që do të jetë përgjegjës për zhvillimin e procedurës së shqyrtimit gjyqësor.

2. Trupi gjykues siguron që shqyrtimi gjyqësor të jetë i drejtë dhe i shpejtë dhe që procedurat të zhvillohen në pajtim me rregullat e procedurës dhe provave, në respekt të plotë të drejtave të akuzuarit dhe duke i kushtuar kujdesin e duhur mbrojtjes së viktimave dhe dëshmitarëve. Pasi t'i ketë dëgjuar palët, trupi gjykues mund të miratojë procedura dhe modalitete që janë të nevojshme për të mundësuar zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të procedurave. Ai mund të japë udhëzime për zhvillimin e procedurave të drejta dhe të paanshme dhe në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe të Provave.

3. Në pajtim me nenin 20, nëse nga gjyqtari i procedurës paraprake ende nuk e ka përcaktuar, trupi gjykues e përcakton gjuhën ose gjuhët e punës që do të përdoren në shqyrtimin

gjqësor. Trupi gjykues po ashtu mund ta ndryshojë përcaktimin e gjyqtarit të procedurës paraprake të bërë sipas nenit 39 (7).

4. Seancat janë publike, përveç nëse trupi gjykues vendosë të zhvillojë seancë me dyer të mbyllura, në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave.

5. Në bashkërendim me Administratorin e Zyrës së Regjistrimit, trupi gjykues siguron mbajtjen, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e regjistrimit të plotë dhe të saktë të procedurës.

6. Para shqyrtimit gjyqësor ose gjatë shqyrtimit gjyqësor, kur është e nevojshme trupi gjykues mund:

- a. të ushtrojë çdo funksion ose kompetencë të gjyqtarit të procedurës paraprake të përcaktuara në nenin 39,
- b. t'u kërkojë palëve t'u përmbahen detyrimeve për të mos dhënë informata në publik, siç është e përcaktuar në Rregullat e Procedurës dhe Provave,
- c. të kërkojë praninë dhe dëshminë e dëshmitarëve dhe paraqitjen e dokumenteve dhe të provave të tjera, nëse është e nevojshme, duke siguruar asistencën e shteteve, siç përcaktohet me këtë ligj,
- d. të sigurojë mbrojtjen e informacionit të klasifikuar,
- e. të urdhërojë nxjerrjen e provave krahas atyre që janë mbledhur para shqyrtimit gjyqësor ose që janë paraqitur nga ana e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor,
- f. të sigurojë mbrojtjen e të akuzuarve, dëshmitarëve dhe viktimave,
- g. të marrë çdo masë të nevojshme për të ruajtur rendin gjatë seancës dhe
- h. të nxjerrë vendim për çdo çështje tjetër përkatëse, përfshirë për pranueshmërinë e provave.

7. Pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor, me pëlqimin e trupit gjykues Prokurori i specializuar mund t'i tërheqë akuzat kundër të akuzuarit. Në rast se gjatë shqyrtimit gjyqësor provat e paraqitura tregojnë se gjendja faktike e përshkruar në aktakuzë ka ndryshuar, Prokurori i specializuar, me lejen e trupit gjykues që e ka dëgjuar të akuzuarin, mund ta ndryshojë aktakuzën përshtatshëmrisht, duke përfshirë shtimin e akuzave shtesë apo zëvendësimin e akuzave më të rënda. Në këto rrethana, i akuzuari mund të kërkojë shtyrjen e shqyrtimit gjyqësor për t'i dhënë kohë të arsyeshme për përgatitjen e mbrojtjes në lidhje me ndryshimin. Nëse aktakuza ndryshohet apo zgjerohet në masë të konsiderueshme, trupi gjykues e shtyn shqyrtimin gjyqësor për të mundësuar këtë përgatitje.

Neni 41 Paraburgimi

1. Askush nuk privohet nga liria nga Dhomat e specializuara ose Prokurori i specializuar, apo në emër të tyre, përveç në rrethanat dhe në pajtim me procedurat e përcaktuara nga ky ligj dhe mbrojtjet e garantuara në nenin 29 të Kushtetutës.

2. Çdo person që privohet nga liria me anë të arrestimit ose paraburgimit ka të drejtë që sipas procedurave të parashikuara në këtë ligj dhe sipas rregullave të procedurës dhe provave të paraqesë ankesë lidhur me ligjshmërinë e arrestimit të tij dhe kushtet e paraburgimit, dhe që ajo ankesë të vendoset me shpejtësi nga Dhomat e specializuara dhe nëse ai paraburgim nuk është i ligjshëm, të urdhërohet lirimi i tij ose saj.

3. Kushdo që privohet nga liria pa urdhër nga Dhomat e specializuara duhet që brenda dyzet e tetë (48) orëve të sillet personalisht para ndonjë gjyqtari të Dhomave të specializuara, i cili vendosë lidhur me paraburgimin ose lirimimin e tij jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur i ndaluar sillet para gjykatës.

4. Kushdo që privohet nga liria nga Dhomat e specializuara ose Zyra e Prokurorit të Specializuar, ose në emër të tyre, informohet menjëherë në gjuhën që ai e kupton për:

- a. arsyet e arrestimit të tij, që pasohet me arsyet me shkrim sa më shpejt të jetë e mundur,
- b. të drejtën e ndihmës ligjore përmes mbrojtësit nga Dhomat e specializuara të zgjedhur prej tij dhe që atij t'i caktohet mbrojtësi i specializuar pa pagesë nëse ai nuk ka mjete të mjaftueshme për pagesë dhe
- c. të drejtën për ta njoftuar ose për të kërkuar që t'i njoftohet ndonjë anëtar i familjes apo person tjetër i zgjedhur prej tij lidhur me arrestimin e tij ose saj.

5. Personi i privuar nga liria nga Dhomat e Specializuara ose në emër të tyre, transferohet me mënyrën e udhëtimit të specifikuar në ndonjë urdhër të Dhomave të specializuara dhe sillet para gjyqtarit të Dhomave të specializuara pa vonesë dhe ka të drejtën për shqyrtim gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme ose për t'u liruar në pritje të shqyrtimit gjyqësor. E drejta e ankesës së përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni vlen, po ashtu, edhe për urdhër transferin sipas këtij paragrafi.

6. Dhomat e specializuara apo Prokurori i Specializuar urdhërojnë arrestimin dhe paraburgimin e një personi vetëm kur:

- a. ekziston dyshimi i bazuar se ai e ka kryer ndonjë vepër penale që është nën juridiksionin e Dhomave të specializuara dhe
- b. ekzistojnë arsye të artikulueshme të besohet se:
 - i. ekziston rreziku i arratisjes,
 - ii. se ai ose ajo do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e ndonjë vepre penale, ose rrethanat specifike tregojnë se ai do të pengojë

ecurinë e procedurës penale duke ndikuar tek dëshmitarët, palët e dëmtuara ose bashkëfajtorët, ose

iii. natyra e rëndë e veprës penale, ose mënyra apo rrethanat në të cilat është kryer dhe karakteristikat personale të tij, sjellja e tij në të shkuarën, mjedisi dhe kushtet në të cilat ai jeton, ose rrethanat e tjera personale e tregojnë rrezikun se ai do ta përsërisë veprën penale, do të përfundojë ndonjë vepër penale në tentativë, ose do të kryejë ndonjë vepër penale që ai ka kërcënuar se do ta kryejë.

7. Personat që janë subjekt i urdhrit të paraburgimit lëshuar nga Dhomat e Specializuara mund të paraburgosen në ambiente të paraburgimit të mbikëqyrura nga Dhomat e Specializuara dhe të menaxhuara nga Zyra Administrative. Në rast se procedura bartet pjesërisht ose tërësisht në shtetin pranues sipas nenit 3, këto ambiente të paraburgimit duhet të jenë afër selisë së Dhomave të Specializuara në shtetin pranues.

8. Ambientet e paraburgimit të Dhomave të Specializuara i plotësojnë standardet ndërkombëtare përkatëse dhe inspektohen dhe monitorohen nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC) ose ndonjë organizatë tjetër ndërkombëtare që pranon t'i inspektojë dhe monitorojë ato ambiente.

9. Administratori miraton Rregullat e Paraburgimit, Ankesave dhe Procedurave Disiplinore për ambientet e paraburgimit në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe sipas udhëzimeve të neneve 194-202 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Ligji nr. 04/L-123.

10. Deri në kohën kur aktgjykimi të merr formën e prerë ose deri në lirimin nga paraburgimi, me kalimin e dy (2) muajve pas aktvendimit të fundit për paraburgim, gjyqtari i procedurës paraprake ose trupi gjykues i informuar për rastin shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për paraburgim dhe nxjerrin aktvendim për lirimin apo ndërprerjen e paraburgimit. Palët mund të paraqesin ankesë kundër këtij aktvendimi në Panelin e Gjykatës së Apelit.

11. Në rast të lirit, personat që mbahen në ambientet e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në shtetin pranues nuk lirohen në shtetin pranues. Këta persona transportohen dhe lirohen në shtetin ku janë paraburgosur fillimisht në emër të Dhomave të Specializuara apo në Kosovë, apo nëse ata nuk kanë të drejtë për të qëndruar në asnjë prej atyre vendeve, në ndonjë shtet ku ata janë banorë të zakonshëm dhe/apo të ligjshëm, apo në ndonjë Shtet që pajtohet t'i pranojë ata.

12. Përveç paraburgimit, Dhomat e specializuara mund t'i urdhërojnë edhe masat në vijim për ta siguruar praninë e të akuzuarit (përfshirë përmes video telekonferencës) gjatë procedurës, për ta parandaluar përsëritjen e kryerjes së veprës apo për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale:

a. fletëthirrjet,

b. urdhër-arresti,

c. dorëzani me lirim në Kosovë, nëse i akuzuari pajtohet që procedurën ta vijojë përmes video telekonferencës,

- d. paraburgim shtëpiak në Kosovë, nëse i akuzuari pajtohet që procedurën ta vijojë përmes video telekonferencës,
- e. premtim që të mos largohet nga vendbanimi aktual në Kosovë, nëse i akuzuari pajtohet që procedurën ta vijojë përmes video telekonferencës,
- f. ndalimi nga afrimi i vendeve apo personave të caktuar,
- g. paraqitja në stacionin e policisë apo në ndonjë vend tjetër në Kosovë, nëse i akuzuari pajtohet që procedurën ta vijojë përmes video telekonferencës dhe
- h. devijimin.

Neni 42

Fletëthirrjet për dëshmitarët

1. Dhomat e Specializuara ose Prokurori i Specializuar mund të thërrasin ndonjë dëshmitar nëse ekziston mundësia që ai të ketë informacion në lidhje me ndonjë vepër penale, kryesin e veprës penale ose rrethanat e rëndësishme për procedurën penale.
2. Viktima mund të merret në pyetje si dëshmitar.
3. Çdo person që është i pranishëm në Kosovë dhe që thirret si dëshmitar e ka për detyrë t'i përgjigjet thirrjes dhe të dëshmojë përveç nëse parashihet ndryshe në këtë ligj ose në Rregullat e Procedurës dhe Provave të Dhomave të Specializuara.
4. Dëshmitarëve që udhëtojnë për në selinë e Dhomave të Specializuara do t'ju sigurohet udhëtimi, akomodimi si dhe mëditjet për shpenzimet e udhëtimit e tyre sipas nevojës.
5. Kur kërkohet nga Dhomat e Specializuara, gjykatat e tjera të Kosovës dhe zyrtarët e tyre do të ndihmojnë për dërgimin apo zbatimin e thirrjeve të dëshmitarëve të lëshuara nga Dhomat e specializuara. Mbrojtja e dëshmitarëve, siguria dhe konfidencialiteti merren parasysh dhe shqyrtohen para çdo kërkesë të tillë.
6. Dhomat e specializuara mund të bëjnë aranzhime sipas neneve 4 dhe 55, apo të kërkojnë asistencë sipas nenit 55 nga shtetet e tjera në të cilat dëshmitarët janë të pranishëm për ta siguruar praninë e atyre dëshmitarëve para Dhomave të Specializuara.
7. Nëse dëshmitari që është thirrur në mënyrë të rregullt nuk paraqitet ose nuk e arsyeton mosparaqitjen e tij ose në qoftë se ai largohet nga vendi ku ai duhet të merrej në pyetje pa leje apo ndonjë arsye të vlefshme, ai dëshmitar mund të detyrohet të paraqitet dhe mund të gjobitet deri në dyqind e pesëdhjetë (250) euro për secilën herë që ai ose ajo nuk paraqitet.
8. Nëse dëshmitari paraqitet pasi të jetë thirrur por pasi paralajmërohet për pasojat refuzon të dëshmojë pa arsyetim ligjor, ai mund të gjobitet deri në dyqind e pesëdhjetë (250) euro. Nëse dëshmitari refuzon të dëshmojë edhe pasi të jetë gjobitur, ai mund të burgoset. Burgimi zgjat për aq kohë sa dëshmitari refuzon të dëshmojë apo derisa dëshmimi i tij bëhet i panevojshëm, ose derisa procedura penale të përfundojë, por nuk e tejkalon periudhën prej një (1) muaji.

9. Ankesa kundër aktvendimit me të cilin shqiptohet dënimi me gjobë ose me burgim sipas këtij neni vendoset nga Paneli i Gjykatës së Apelit. Ankesa kundër aktvendimit për burgim nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit. Dënimi sipas paragrafëve 7 dhe 8 të këtij neni shqiptohet nga një gjyqtar.

Neni 43 Aktgjykimi

1. Trupi Gjykues merr dhe shpallë aktgjykime dhe shqipton dënimin ndaj personave e shpallur fajtorë për krime që janë në juridiksionin e Dhomave të specializuara.

2. Aktgjykimi merret nga shumica e gjyqtarëve të trupit gjykues, dhe shpallet nga trupi gjykues publikisht. Këtij aktgjykimi i bashkëngjitet mendimi i arsyetuar me shkrim, të cilit mund t'i bashkëngjiten mendimet e ndara apo të ndryshme.

Neni 44 Dënimet

1. Dhomat e specializuara mund të shqiptojnë kundër personit të dënuar burgim deri në një afat maksimal të burgimit të përgjithshëm.

2. Në shqyrtimin e dënimit që do të shqiptohet kundër personit të shpallur fajtor për ndonjë krim ndërkombëtar sipas këtij ligji, Dhomat e Specializuara e marrin parasysh,

- a. shkallën e dënimit për atë krim e përcaktuar sipas ligjit të Kosovës në kohën e kryerjes së tij,
- b. ndonjë shkallëzim të mëtutjeshëm dënimi më të butë për krimin e parashikuar në ligjin e Kosovës dhe
- c. nenin 7(2) të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe nenin 15 (2) të Marrëveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të përfshira dhe të mbrojtura me nenet 22 (2), 22 (3) dhe 33 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe shkallën në të cilën ndëshkimi i veprimeve ose mosveprimeve të cilat ishin kriminale sipas parimeve të përgjithshme të ligjit të njohura nga kombet e qytetëruara do të paragjykohehin me zbatimin e 2 (a) dhe (b).

3. Në shqyrtimin e dënimit që do të shqiptohet kundër personit të shpallur fajtor për ndonjë krim vendor sipas nenit 15(1), Dhomat e Specializuara e marrin parasysh:

- a. shkallën e dënimit për atë krim të përcaktuar sipas ligjit të Kosovës në kohën e kryerjes së tij.
- b. ndonjë shkallëzim të mëtutjeshëm dënimi më të butë për krimin e parashikuar në ligjin e Kosovës.

4. Dënimi i shqiptuar kundër personave të shpallur fajtorë për krimet sipas nenit 14(2) është në përputhje me dënimet për krimet e përcaktuara në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2012, Ligji Nr 04/L-082.

5. Për shqiptimin e dënimit, Dhomat e specializuara marrin parasysh faktorët rëndues dhe lehtësues, përfshirë peshën e krimit dhe pasojat e tij, si dhe rrethanat individuale të personit të dënuar.

6. Përveç dënimit me burg, Dhomat e specializuara mund ta urdhërojnë vetëm personin e dënuar që ta dëmshpërblejë ose ta kompensojë viktimën apo viktimat bashkërisht, ose mund ta urdhërojnë konfiskimin e pronës, të ardhurave dhe të aseteve që përdoren për kryerjen e krimit dhe që rrjedhin nga kryerja e krimit dhe kthimin e tyre tek pronari i ligjshëm apo shitjen dhe ndarjen mes viktimave sipas nenit 22 (“Urdhri për zhdëmtim”).

7. Kur personi i shpallur fajtor nga Dhomat e specializuara është, po ashtu, i dënuar me burgim nga ndonjë gjykatë tjetër e Kosovës, dënimi me burgim i shqiptuar nga ana e Dhomave të Specializuara konsiderohet se është duke u mbajtur njëkohësisht me dënimin paraprak përveç nëse urdhërohet ndryshe.

Neni 45 **Ankesat e ndërmjetme**

1. Ankesat e ndërmjetme të paraqitura nga i akuzuari apo nga Prokurori i specializuar në pajtim me këtë ligj dhe me Rregullat e Procedurës dhe Provave shqyrtohen nga paneli i Gjykatës së Apelit.

2. Ankesat e ndërmjetme do të jenë të pranueshme që nga marrja e vendimeve apo urdhrave që kanë të bëjnë me paraburgimin apo me ndonjë parashtrësë paraprake për kundërshtimin e juridiksionit të Dhomave të Specializuara. Çdo ankese tjetër të ndërmjetme duhet t’i aprovohet leja për ankesë përmes vërtetimit nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake ose trupit gjykues mbi bazën e asaj se ajo përfshinë një çështje e cila do të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të procedurave ose në rezultatin e shqyrtimit gjyqësor dhe për të cilën, sipas mendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake ose të trupit gjykues, zgjidhja e menjëhershme nga ndonjë Panel i Gjykatës së Apelit mund ta avancojë materialisht procedurën.

Neni 46 **Procedurat ankimore në shkallë të dytë**

1. Ankesat kundër aktgjykimit të marrë nga trupi gjykues të paraqitura nga personat e dënuar apo nga prokurori i specializuar shqyrtohen nga ndonjë Panel i Gjykatës së Apelit për këto arsye:

- a. ndonjë gabimi rreth ndonjë çështje juridike që e shfuqizon aktgjykimin,
- b. ndonjë gabimi faktik i cili ka shkaktuar dështimin e drejtësisë ose
- c. ndonjë gabimi për sa i përket dhënies së dënimit.

2. Ankesa nuk është gjykim *de novo* (i ri).
3. Paneli i Gjykatës së Apelit mund t'i konfirmojë, t'i kthejë ose t'i rishikojë aktgjykimet e trupit gjykues, apo tëë ndërmarrë veprime tëë tjera tëë duhura.
4. Kur paneli i Gjykatës së Apelit përcakton se ndonjë trup gjykues ka bërë gabim juridik në ndonjë aktgjykim që rrjedhë nga zbatimi i ndonjë standardi të pasaktë ligjor, Dhoma e Gjykatës së Apelit e artikulon standardin e duhur ligjor dhe e zbaton atë standard ndaj provave të përfshira në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor për të përcaktuar nëse fajësia e apeluar duhet të konfirmohet, të pranohet apo të hedhet poshtë. Përndryshe, nëse trupi gjykues është në dispozicion dhe mund ta trajtojë çështjen në mënyrë më efikase, Paneli i Gjykatës së Apelit mund ta kthejë rastin tek trupi gjykues për të rishikuar konstatimet e tij dhe provat bazuar në standardin e duhur ligjor.
5. Me rastin e shqyrtimit të konstatimeve faktike të trupit gjykues, Paneli i Gjykatës së Apelit vetëm i zëvendëson konstatimet e trupit gjykues me konstatimet e veta atëherë kur provat në të cilat është bazuar trupi gjykues nuk kanë mundur të pranohen nga asnjë gjykim i arsyeshëm i fakteve apo kur vlerësimi i provave është tërësisht i gabuar.
6. Kur paneli i Gjykatës së Apelit e hedhin poshtë konstatimin e fajësisë nga ndonjë trup gjykues bazuar në një mënyrë të përgjegjësisë dhe trupi gjykues nuk ka arritur që të bëjë konstatime mbi mënyrat alternative të përgjegjësisë, Paneli i Gjykatës së Apelit i merr parasysh provat që përfshihen në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, si dhe çdo konstatim tjetër të trupit gjykues, për të përcaktuar nëse dënimet duhet të bëhen sipas një mënyre alternative të përgjegjësisë. Përndryshe, nëse trupi gjykues është në dispozicion dhe mund ta trajtojë çështjen në mënyrë më efikase, Paneli i Gjykatës së Apelit mund t'ia kthej rastin trupit gjykues për t'i rishikuar konstatimet dhe provat e tij për të përcaktuar nëse konstatimet e fajësisë të pranohen sipas një mënyre alternative të përgjegjësisë.
7. Aktgjykimi i shkallës së dytë jepet nga shumica e gjyqtarëve të Panelit të Gjykatës së Apelit, dhe shpallet publikisht nga Paneli i Gjykatës së Apelit. Këtij aktgjykimi i bashkëngjitet mendimi i arsyetuar me shkrim, të cilit mund t'i bashkëngjiten mendimet e ndara apo të ndryshme.
8. Përpos nëse trupi gjykues ose Paneli i Gjykatës së Apelit urdhëron që të veprohet ndryshe, personi i dënuar mbetet në ndalim në pritje të ankesës.
9. Gjykata e Apelit gjithashtu mund të shqyrtojë ankesa kundër ndonjë aktgjykimi të trupit gjykues të paraqitur nga mbrojtësi i viktimave por vetëm në lidhje me vendimin e ndonjë paneli lidhur me statusin e viktimës apo ndonjë urdhër për zhdëmtim. Gjatë procedurës së apelit, viktimat pretenduese përfaqësohen kolektivisht si një grup i vetëm nga Mbrojtësi i Viktimave i caktuar nga Zyra e Regjistrimit.

Neni 47

Procedurat ankimore në shkallë të tretë

1. Paneli i Gjykatës Supreme për Dhomat e Specializuara i shqyrton ankesat kundër aktgjykimeve të Panelit të Gjykatës së Apelit nëse Paneli i Gjykatës së Apelit e ka ndryshuar

ndonjë lirim nga fajësia në vend të atij ka vendosur dënim ose kur sanksioni penal i burgimit të përgjeshëm është shqiptuar ose nga trupi gjykues ose nga Paneli i Gjykatës së Apelit.

2. Dispozitat e nenit 46 zbatohen *mutatis mutandi* për procedurën ankimore para Panelit të Gjykatës Supreme për Dhomat e specializuara.

Neni 48 **Mjetet juridike të jashtëzakonshme**

1. Pala mund të kërkojë rihapjen e procedurës penale. Kjo kërkesë paraqitet tek Dhoma e specializuar e Gjykatës Supreme apo përmes aranzhimit të dakorduar, nëse një i tillë ekziston për atë qëllim në pajtim me nenin 60 (mekanizmi i mbetur).

2. Procedura penale që është ndërprerë me aktgjykim të formës së prerë mund të rihapet vetëm në rast se:

- a. dëshmohet se aktgjykimi është mbështetur mbi ndonjë dokument të falsifikuar ose mbi ndonjë deklaratë të rreme të dëshmitarit, ekspertit apo përkthyesit,
- b. dëshmohet se aktgjykimi ka rezultuar nga një veprë penale e kryer nga gjyqtari apo ndonjë person i cili ka ndërmarrë veprimet hetimore,
- c. zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja të cilat në kohën e procedurës nuk ishin të njohura për trupin gjykues apo Panelin e Gjykatës së Apelit, dhe të cilat, të vetme ose në lidhje me provat e mëparshme, do të përbënin faktor vendimtar për marrjen e vendimit dhe do të kishin ndryshuar rrënjësisht baraspeshën e provave të rastit, duke çuar në një dështim të drejtësisë në rast se ato do të shpërfillehin, ose
- d. ndonjë person është gjykuar më shumë se një herë për veprën e njëjtë apo disa persona janë dënuar për veprën e njëjtë që ka mundur të jetë kryer prej vetëm një personi apo prej vetëm disa prej tyre.

3. Në lidhje me paragrafin 2(a) ose (b) të këtij neni, procedura penale mund të rihapet vetëm në favor të të akuzuarit, përveç se nëse dëshmohet se rrethanat kanë qenë rezultat i ndonjë veprë penale që është kryer nga i akuzuari apo ndokush që ka vepruar në emër të tij apo për interesin e tij kundër ndonjë dëshmitari, dëshmitari ekspert, përkthyesi, prokurori, gjyqtari, zyrtari tjetër të Dhomave të Specializuara apo të Zyrës së Prokurorit të Specializuar apo kundër atyre që janë të afërt me këta persona, procedura penale mund të rihapet kundër të të akuzuarit.

4. Pas një shqyrtimi paraprak, Paneli i Gjykatës Supreme, apo një panel *ad hoc* i caktuar nga një Aranzhim i Dakorduar mund të:

- a. hedhë poshtë kërkesën,
- b. rihap procedurën penale dhe
 - i. ta rimbledhin trupin gjykues, nëse është në dispozicion, ose
 - ii. nëse është e përshtatshme, të ruajnë juridiksion mbi çështjen.

5. Pala mund të kërkojë zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit në çfarëdo kohe gjatë periudhës së kaluar në burg, por jo gjatë gjashtë (6) muajve të fundit të burgimit. Kjo kërkesë duhet të dorëzohet në Dhomat e specializuara të Gjykatës Supreme apo përmes aranzhimit të dakorduar, nëse një i tillë ekziston për atë qëllim në përputhje me nenin 60 (mekanizmi i mbetur)

6. Pala mund të kërkojë mbrojtjen e ligjshmërisë brenda tre (3) muajve që nga aktgjykimi i formës së prerë ose aktvendimi i formës së prerë kundër të cilit kërkohet mbrojtja e ligjshmërisë. Gjatë procedurave penale që nuk janë përfunduar me formë të prerë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet vetëm kundër vendimeve të formës së prerë për caktimin apo vazhdimin e paraburgimit. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dorëzohet në dhomat e specializuara të Gjykatës Supreme apo përmes aranzhimit të dakorduar, nëse një i tillë ekziston për atë qëllim në pajtim me nenin 60 (mekanizmi i mbetur).

7. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë duhet të pretendojë:

- a. shkelje të së drejtës penale të përfshirë në kuadër të këtij ligji, ose
- b. shkelje esenciale të procedurave të përcaktuara në këtë ligj dhe në Rregullat e procedurës dhe provave.

8. Kërkesa për mjete juridike të jashtëzakonshme sipas këtij neni mund të paraqitet në bazë të të drejtave në dispozicion sipas këtij ligji të cilat janë të mbrojtura me Kushtetutë ose Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut.

Neni 49

Peticioni në Gjykatën Kushtetuese

1. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës në lidhje me juridiksionin lëndor dhe punën e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

2. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese ka juridiksion mbi çdo referim tek Gjykata Kushtetuese të bërë nga personat e autorizuar për të bërë referime në bazë të nenit 113 të Kushtetutës që ndërlidhen me, apo që kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi, punën, vendimet, urdhrat apo aktgjykimet e Dhomave të Specializuara apo me punën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

3. Në pajtim me nenin 113(7) të Kushtetutës, individët, përfshirë të akuzuarit dhe viktimat, janë të autorizuar që t'i drejtohen Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese lidhur me shkeljet e të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, që pretendohen se janë bërë nga Dhomat e Specializuara apo nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, por vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

4. Në pajtim me nenin 113(8) të Kushtetutës, Dhomat e Specializuara mund t'i drejtojnë pyetje Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese lidhur me përputhshmërinë kushtetuese të ndonjë ligji, kur ajo çështje ngritët gjatë ndonjë procedure gjyqësore, kur Dhomat e specializuara nuk janë të sigurta për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me

Kushtetutën dhe kur vendimi i Dhomave të specializuara për rastin e caktuar varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë.

5. Në pajtim me Amendamentin nr. 24 dhe nenin 135(4) të Kushtetutës, Ombudspersoni i Dhomave të Specializuara i caktuar sipas nenit 34(9) të këtij ligji, si dhe Ombudspersoni i Republikës së Kosovës, mund t'i referohen sipas nenit 113(2) Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

6. Gjyqtarët e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese përcaktojnë organizimin e vet të brendshëm, proceset e vendimmarrjes dhe çështjet e tjera organizative lidhur me Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në pajtim me Amendamentin nr. 24 të Kushtetutës dhe këtë ligj. Rregullat e Procedurës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese përfshihen në Rregullat e Procedurës dhe Provave sipas nenit 19.

Neni 50

Ekzekutimi i dënimit me burgim

1. Vuajtja e burgimit bëhet në njërin shtet që Kryetari i Dhomave të Specializuara cakton nga mesi i atyre shteteve që kanë treguar gatishmëri për t'i pranuar personat e dënuar nga Dhomat e Specializuara për kohëzgjatjen e dënimit të shqiptuar, në pajtim me aranzhimet e bëra nga Dhomat e Specializuara.

2. Kushtet e burgimit rregullohen sipas ligjit të shtetit që e ekzekuton dënimin me burgim nën mbikëqyrjen e Dhomave të Specializuara ose sipas Aranzhimit të Dakorduar, nëse një i tillë ekziston për atë qëllim në përputhje me nenin 60 (mekanizmi i mbetur) të këtij ligji. Vetëm Dhomat e Specializuara mund ta ndryshojnë kohëzgjatjen e dënimit sipas nenit 51 të këtij ligji për faljen dhe ndërrimin e dënimit.

Neni 51

Falja ose ndërrimi i dënimeve

1. Vendimet e Dhomave të Specializuara nuk i nënshtrohen asnjë faljeje dhënë sipas nenit 84 (29) të Kushtetutës, apo ndonjë person i dënuar nga Dhomat e Specializuara, pavarësisht se ku e shërbejnë dënimin e tyre.

2. Kohëzgjatja e dënimit mund të modifikohet, ndryshohet apo ndërrohet vetëm nga Dhomat e Specializuara apo me aranzhimin e dakorduar, nëse ekziston ndonjë i tillë për atë qëllim në pajtim me nenin 60 (mekanizmi i mbetur). Dhomat e Specializuara, apo Aranzhimi i Dakorduar, kërkojnë njoftim nga shteti përkatës nëse sipas ligjit të zbatueshëm të shtetit në të cilin personi i dënuar është i burgosur, ai ka të drejtë për ndërrimin të dënimit. Dënimi mund të ndërrohet vetëm nëse Kryetari i Dhomave të Specializuara, në konsultim me gjyqtarët e Dhomave të Specializuara, vendosë për një gjë të tillë në bazë të interesave të drejtësisë dhe parimeve të përgjithshme të së drejtës.

3. Personi i dënuar i cili është në vuajtje të dënimit të tij mund të paraqesë kërkesë tek Dhomat e Specializuara nëse kushtet e burgimit nuk u përgjigjen standardeve ndërkombëtare apo mbrojtjeve të parapara me Kushtetutë. Kryetari i Dhomave të Specializuara e emëron një

gjqqtar të vetëm për ta shqyrtuar këtë kërkesë sipas nenit 33(2), në përputhje me rregullat për caktimin e gjyqtarëve të Dhomave të specializuara miratuara sipas nenit 25(2).

KAPITULLI VII NDËRVEPRIMI ME GJYKATAT DHE SUBJEKTET E KOSOVËS

Neni 52

Statusi, privilegjet dhe imunitetet e Dhomave të Specializuara në Kosovë

1. Statusi, privilegjet dhe imunitetet që i kanë zyrat dhe personeli i EULEX Kosova sipas Ligjit nr. 03/L-033 për statusin, imunitetet dhe privilegjet e misionëve diplomatike dhe konsullore në Republikën e Kosovës dhe personelit ndërkombëtar ushtarak, shtrihet për objektet, pronën, dokumentet dhe personelin e Dhomave të specializuara dhe Prokurorinë e specializuar në Kosovë. Përveç kësaj, avokatët, ekspertët, dëshmitarët ose çdo person tjetër që kryen funksione si pjesë e punës së Dhomave të specializuara dhe Prokurorisë së specializuara do të gëzojnë të njëjtin status, privilegje dhe imunitete.

2. Objektet, prona, fondet, pasuria, arkivat dhe të dhënat e Dhomave të specializuara, Zyrës së regjistrimit dhe Prokurorisë së specializuar, kudo që janë të vendosura dhe nga kushdo që mbahen, janë të paprekshme dhe ka imunitet nga bastisja, sekuestrimi, marrja, konfiskimi, shpronësimi, qasja publike ose nga çdo formë tjetër e ndërhyrjes qoftë me veprim ekzekutiv, administrativ, gjyqësor apo legjislativ.

3. Dhomat e Specializuara, krerët e tyre, gjyqtarët dhe stafi i tyre nuk i nënshtrohen asnjë mase ose veprimi nga qeveria apo autoritetet e Kosovës apo asnjë subjekti apo personi në Kosovë të cilat mund të ndikojë në ushtrimin e lirë dhe të pavarur të funksioneve të tyre sipas këtij ligji.

Neni 53

Bashkëpunimi dhe asistenca gjyqësore

1. Duke i pasur parasysh të drejtat e të akuzuarit të përcaktuara në nenin 21, të gjitha subjektet dhe personat në Kosovë bashkëpunojnë me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe pa vonesë e respektojnë çdo kërkesë për asistencë ose urdhrat apo vendimet e dhëna nga Dhomat e Specializuara apo Zyra e Prokurorit të Specializuar, duke i përfshirë, por jo vetëm këto:

- a. identifikimin dhe vendndodhjen e personave ose sendeve,
- b. marrjen e dëshmive, duke përfshirë marrjen e dëshmive nën betim, dhe dhënien e provave, duke i përfshirë opinionet dhe raportet e ekspertëve,
- c. marrjen në pyetje të personave që janë nën hetime apo që ndiqen penalisht,
- d. lehtësimin e marrjes në pyetje dhe paraqitjes së personave si dëshmitarë ose ekspertë përpara Dhomave të Specializuara,
- e. mbrojtjen e viktimave, dëshmitarëve potencialë dhe familjet e këtyre,

- f. ekzaminimin e vendeve apo vendngjarjeve, duke përfshirë hetimet e vendit të ngjarjes, dhe zhvarrosjen si dhe ekzaminimin e lokacioneve të varrezave,
- g. sigurimin e të dhënave dhe dokumenteve, duke përfshirë të dhënat dhe dokumentet zyrtare,
- h. ruajtjen e provave,
- i. dhënien e dokumenteve, duke përfshirë edhe dokumentet gjyqësore,
- j. arrestimin ose paraburgimin e personave,
- k. dorëzimin apo transferimin e personave për në Dhomat e Specializuara,
- l. identifikimin, gjurmimin dhe ngrirjen ose konfiskimin e të ardhurave, pronës dhe pasurisë ose frutave të krimeve për qëllime të konfiskimit eventual, pa i paragjykuar të drejtat e palëve të treta *bon fide* dhe
- m. çdo lloj tjetër të asistencës e cila nuk është e ndaluar me ligj, me synimin për ta lehtësuar hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.

2. Urdhrat e dhëna nga Dhomat e Specializuara kanë fuqinë dhe efektin e njëjtë me ato të urdhrave të dhëna nga ndonjë gjykatë apo gjyqtar tjetër i Kosovës. Çdo person fizik, korporatë, autoritet ose subjekt tjetër në Kosovë vepron në përputhje me urdhrin, vendimin apo kërkesën e lëshuar nga Dhomat e Specializuara. Çdo subjekt apo person që i ekzekuton urdhrat e Dhomave të Specializuara vepron në përputhje me udhëzimet e dhëna në atë urdhër.

3. Fletarrestimet e lëshuara nga Dhomat e Specializuara e kanë fuqinë dhe efektin e njëjtë me atë të fletarrestimeve të lëshuara nga ndonjë gjykatë tjetër e Kosovës. Kur ky fletarrestim ekzekutohet, polici i cili e kryen arrestimin e transferon personin e arrestuar nën ndalimin e Dhomave të specializuara. Pavarësisht dërgimit formal të personit nën ndalimin e Dhomave të Specializuara, ai person mund të paraburgoset në ndonjë ambient paraburgimi në Kosovë në emër të Dhomave të Specializuara nëse kjo gjë kërkohet deri në kryerjen e transferimit për në ambientet e paraburgimit të Dhomave të Specializuara.

4. Kur Dhomat e Specializuara urdhërojnë konfiskimin e pronës, të ardhurave apo pasurive, ato i dorëzohen Dhomave të Specializuara pa vonesë, pa i paragjykuar të drejtat e palëve të treta në mirëbesim, dhe në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave.

5. Prona, ose të ardhurat nga shitja e pasurisë së patundshme ose, sipas nevojës shitja e pronave të tjera, që merret në Kosovë si rezultat i ekzekutimit të ndonjë aktgjykimi të Dhomave të specializuara transferohen në kujdestarinë dhe kontrollin e Dhomave të Specializuara pa vonesë. Ligji nr. 03/L-141 për administrimin dhe menaxhimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nuk vlen për urdhrat apo aktgjykimet e Dhomave të Specializuara apo çështjet që shqyrtohen nga to.

Neni 54

Ndërveprimi me Gjykatat dhe Prokuroritë Tjera në Kosovë

1. Në secilin nivel të sistemit të gjykatave në Kosovë, Dhomat e specializuara kanë përparësi ndaj të gjitha gjykatave të tjera në Kosovë në lidhje me juridiksionin lëndor të tyre.
2. Dhomat e Specializuara ose Prokurori i Specializuar mund të urdhërojnë transferimin e procedurave dhe hetimeve brenda juridiksionit lëndor të tyre nga ndonjë gjykatë apo prokuror tjetër në territorin e Kosovës tek Dhomat e Specializuara dhe Prokurori i Specializuar.
3. Gjykata apo prokurori që e merr këtë urdhër i transferon të gjitha dosjet që kanë të bëjnë me rastin e e kërkuar pa vonesë tek Dhomat e Specializuara apo Zyra e Prokurorit të Specializuar, sipas nevojës.
4. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Supreme mund të urdhërojë transferimin e ndonjë kërkesë për mjete të jashtëzakonshme që ndërlidhet me punën e Dhomave të Specializuara apo që ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi punën e tyre. Në këto raste, gjykata që e bën transferimin e transferon referimin dhe dosjen e saj të rastit pa vonesë dhe e njofton kërkuesin lidhur me transferimin e bërë.
5. Urdhrat për transferim nga paragrafët e mëparshëm janë të formës së prerë dhe detyrues.
6. Të gjitha gjykatat dhe prokurorët e Kosovës i njoftojnë Dhomat e specializuara dhe Prokurorinë e specializuar pa vonesë në rast se ato janë në dijeni për ndonjë hetim, rast apo procedurë penale brenda juridiksionin lëndor të Dhomave të specializuara.
7. Në përputhje me nenin 53, Dhomat e Specializuara dhe Prokurori i Specializuar mund të kërkojnë ndihmën e ndonjë prokurori apo gjykate të Kosovës për t'i përmbushur funksionet e tyre sipas këtij ligji. Çdo kërkesë e tillë do të përmbushet pa vonesë.
8. Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar mund t'ia bashkëngjisin masat e konfidencialitetit ndonjë urdhri apo kërkesë që i bëhet gjykatës apo prokurorit në Kosovë, si dhe përgjigjeve apo veprimeve në lidhje me to.
9. Gjykatat dhe prokurorët në Kosovë mund të kërkojnë ndihmën ose bashkëpunimin e Dhomave të Specializuara ose Prokurorit të Specializuar. Këto kërkesa bëhen me shkrim dhe i drejtohen Kryetarit të Dhomave të Specializuara apo Prokurorit të Specializuar, përkatësisht.

KAPITULLI VIII

BASHKËPUNIMI DHE ASISTENCA ME SHTETET, ORGANIZATAT DHE SUBJEKTET E TJERA

Neni 55

Kërkesat për asistencë dhe bashkëpunim

1. Dhomat e Specializuara, Zyra Administrative dhe Prokurori i Specializuar mund të kërkojnë asistencën dhe bashkëpunimin nga shtetet e tjera, organizatat ndërkombëtare dhe subjektet e tjera sipas nevojës për zhvillimin e hetimeve dhe ndjekje penale të personave që

akuzohen për kryerjen e krimeve brenda juridiksionit lëndor të Dhomave të Specializuara, si dhe për përmbushjen e përgjegjësive të tjera të Dhomave të Specializuara. Dhomat e Specializuara, Zyra Administrative dhe Prokurori i Specializuar mund të bëjnë aranzhime që janë të nevojshme për këtë qëllim.

2. Përveç kësaj, Dhomat e Specializuara, Zyra Administrative dhe Prokurori i Specializuar gjithashtu mund t'i shfrytëzojnë marrëveshjet për ndihmë juridike reciproke të lidhura nga Kosova ose mund të paraqesin kërkesë për ndihmë në bazë të parimit të reciprocitetit. Në rrethana të tilla, për arsye të konfidencialitetit, këto kërkesa me shkrim i dërgohen drejtpërdrejt pranuesit.

3. Ligji nr. 04/L-031 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar për çështje penale nuk zbatohet për Dhomat e Specializuara ose Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

Neni 56 Privilegjet dhe imunitetet

1. Dhomat e Specializuara, Zyra Administrative dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar mund të bëjnë marrëveshje me ato shtete që bien dakord për t'i siguruar privilegjet, imunitetet, përjashtimet dhe objektet që janë të nevojshme për përmbushjen e funksioneve dhe qëllimeve të tyre të përcaktuara në këtë ligj, përfshirë për ndërtesat, pronat, dokumentet, krerët, personelin dhe personat e tjerë të tyre që kryejnë funksione të nevojshme për përmbushjen e qëllimeve të tyre, duke i përfshirë avokatët, ekspertët, dëshmitarët dhe të tjerët.

2. Dhomat e Specializuara, Zyra Administrative dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar mund të bëjnë marrëveshje me ato shtete që bien dakord për të siguruar se ndërtesat, pronat, fondet, pasuritë, arkivat, shënimet dhe dokumentet e tyre, kudo që ndodhen dhe nga kushdo që mbahen, do të jenë të pacënueshme dhe të gëzojnë imunitet nga bastisjet, sekuestrimi, marrja, konfiskimi, shpronësimi, qasja publike ose çdo formë tjetër e ndërhyrjes qoftë me veprim ekzekutiv, administrativ, gjyqësor apo legjislativ.

Neni 57 Vuajtja e dënimit me burg

1. Dhomat e Specializuara dhe Zyra Administrative mund të bëjnë marrëveshje me shtetet të cilat kanë treguar gatishmëri që brenda territoreve të tyre ta lejojnë vuajtjen e dënimeve me burgim të personave që janë shpallur fajtorë nga Dhomat e Specializuara.

2. Kur të jenë bërë këto marrëveshje dhe pasi që aktgjykimi të jetë i formës së prerë, Dhomat e Specializuara mund të urdhërojnë transferimin e personit të dënuar në atë vend të tretë për vuajtjen e dënimit.

3. Dhomat e Specializuara ose Aranzhimi i Dakorduar, nëse ekziston për këtë qëllim në bazë të nenit 59 (mekanizmi i mbetur), e mbajnë përgjegjësinë e tyre mbikëqyrëse deri sa dënimi me burgim të përfundojë dhe personi i dënuar të jetë liruar.

Neni 58
Shtetet e Treta dhe Institucionet Ndërkombëtare

Shtetet e Treta dhe Institucionet Ndërkombëtare mund të bëjnë kërkesa për masat e nevojshme që duhet të ndërmerren në lidhje me mbrojtjen e nëpunësve ose agjentëve të tyre dhe për mbrojtjen e informatave të tyre konfidenciale apo të ndjeshme. Procedura për këto kërkesa përcaktohet në Rregullat e Procedurës dhe Provave.

Neni 59
Shteti pranues

1. Kushtet e ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare në mes të Kosovës dhe shtetit pranues dhe letrave të ndërlidhura me to apo marrëveshjet e bëra ndërmjet shtetit pranues dhe Dhomave të Specializuara ose Zyrës së Prokurorit të Specializuar zbatohen për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar sipas këtij ligji.

2. Dhomat e specializuara mund të kërkojnë asistencën e shtetit pranues nëse është e nevojshme për të ruajtur ligjin dhe rendin brenda ndërtesave të Dhomave të Specializuara ose në afërsi të tyre apo për ta larguar ndonjë person nga ndërtesat e Dhomave të Specializuara.

KAPITULLI IX
ARANZHIMET FUNKSIONALE

Neni 60
Aranzhimet e mbetura

Pasi që Kryetari i Dhomave të Specializuara njofton se të gjitha aktgjykimet nga Dhomat e Specializuara kanë marrë formë të prerë, për menaxhimin e çështjeve të mbetura të Dhomave të Specializuara mund të bëhen aranzhime alternative, me kusht që çdo aranzhim i dakorduar të jetë plotësisht i ndërkombëtarizuar dhe të jetë jashtë Kosovës. ("Aranzhimi i Dakorduar").

Neni 61
Menaxhimi i arkivave

1. Pa paragjykim ndaj kushteve të mëparshme të përcaktuara nga ofruesit e informatave dhe dokumenteve, apo ndaj aranzhimeve të bëra me ta, arkivat e Dhomave të Specializuara, Zyrës Administrative dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar janë pronë e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar, apo ndonjë Aranzhimi të Dakorduar, po që se ekziston për këtë qëllim në përputhje me nenin 60, dhe mirëmbahen në një depo të caktuar jashtë Kosovës.

2. Këto arkiva janë të paprekshme kudo që ndodhen. Dhomat e specializuara apo aranzhimi i dakorduar, nëse ekziston për atë qëllim në përputhje me nenin 60, zbatojnë një sistem për sigurinë e informatave dhe për qasjen në to, duke përfshirë sipas nevojës klasifikimin dhe deklasifikimin e përmbajtjes së arkivave.

3. Kur dokumentacionit ose informacionit i është dhënë statusi konfidencial i mbrojtur nga Dhomat e Specializuara, vetëm ndonjë gjyqtar i Dhomave të Specializuara apo ndonjë gjyqtar

nga Aranzhimi i Dakorduar, nëse ekziston për këtë qëllim në përputhje me nenin 60, mund të lejojë dhënien e atyre informatave të mbrojtura.

4. Kur dokumentacionit ose informacionit i është dhënë statusi konfidencial i mbrojtur nga Prokurori i specializuar, ai dokumentacion apo informacion nuk do të jepet pa pëlqimin paraprak të Prokurorit të Specializuar, ose prokurorit nga Aranzhimi i Dakorduar, nëse ai ekziston për këtë qëllim në përputhje me nenin 60. Kjo vazhdon të vlejë edhe pas përfundimit të procedurave penale para Dhomave të Specializuara.

Neni 62 **Kufizimet në qasje**

1. Duke i pasur parasysh rrethanat e sigurisë dhe privatësisë, dokumentet, letrat, të dhënat dhe arkivat e Dhomave të Specializuara, Zyrës së Regjistrimit dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar nuk konsiderohen dokumente publike të Kosovës. E drejta e përgjithshme për të pasur qasje në të dhënat apo arkivat e Dhomave të Specializuara, përfshirë të Zyrës së Regjistrimit dhe të Zyrës së Prokurorit të specializuar, nuk ekziston.

2. Shtetet, autoritetet prokuroriale dhe gjyqësore, subjektet apo personat e tjerë mund të paraqesin kërkesë tek Dhomat e Specializuara për të pasur qasje në të dhënat e gjykatës me kusht që kjo qasje është në interes të drejtësisë dhe të mbrojtjes dhe ruajtjes së konfidencialitetit dhe mbrojtjes që i jepen personit nga Dhomat e Specializuara ose nga Zyra e Prokurorit të Specializuar.

Neni 63 **Buxheti dhe raportimi**

1. Dhomat e specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar kanë buxhetin e tyre, që nuk vjen nga buxheti i Kosovës.

2. Administratori i zyrës së regjistrimit dhe Prokurori i specializuar mbajnë libra të duhur të llogarive dhe të regjistra të tjerë në lidhje me aktivitetet, pronat dhe financat.

3. Dhomat e Specializuara nuk i nënshtrohen auditimit nga Auditori i Kosovës.

4. Ky ligj mbizotëron mbi të gjitha dispozitat e Ligjit për financat publike dhe menaxhimin, në veçanti pjesët XII dhe XIII (Ligjet Nr. 03/L-048, 03/L-221, 04/L-194 dhe 04/L-116).

Neni 64 **Interpretimi**

Përveç rasteve kur konteksti kërkon qartë një interpretim tjetër, çdo referim që ky ligj i bën një ligji tjetër, një rregulloreje të UNMIK-ut ose akti nënligjor, ose ndonjë dispozite specifike të tyre, interpretohet se përfshin çdo ndryshim dhe të gjitha ndryshimet që u janë bërë atyre. Në rast se një ligj, rregullore ose akt nënligjor i tillë është shfuqizuar dhe është zëvendësuar me legjislacion pasardhës, që e rregullon të njëjtën çështje lëndore, ky referim interpretohet, përveç rasteve kur konteksti kërkon qartë një interpretim tjetër, si të nënkuptojë atë legjislacion pasardhës dhe, kur është e zbatueshme, dispozitën ose dispozitat analoge të tij.

Neni 65
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -053
3 gusht 2015

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L -053

**PËR DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRËN E PROKURORIT TË
SPECIALIZUAR**

Përmbajtja

KAPITULLI I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	1
Neni 1 - Fusha e veprimit dhe qëllimi i ligjit.....	1
Neni 2 – Përputhshmëria me Nenin 55 të Kushtetutës	2
KAPITULLI II - PARIMET THEMELORE	2
Neni 3 – Parimet themeluese	2
Neni 4 - Personaliteti dhe zotësia juridike	4
Neni 5 - Mandati ekzekutiv dhe veprimi.....	4
KAPITULLI III - JURIDIKSIONI DHE LIGJI I ZBATUESHËM	4
Neni 6 - Juridiksioni lëndor	4
Neni 7 – Juridiksioni kohor	5
Neni 8 – Juridiksioni territorial	5
Neni 9 – Juridiksioni personal	5
Neni 10 – Juridiksioni i njëkohshëm.....	5
Neni 11 – Njoftimi për Rastet dhe Procedurat Penale.....	6
Neni 12 - Ligji i zbatueshëm	6
Neni 13 - Krimet Kundër Njerëzimit sipas së Drejtës Ndërkombëtare	6
Neni 14 – Krimet e Luftës sipas së Drejtës Ndërkombëtare	7
Neni 15 – Krime të tjera sipas së drejtës së Kosovës.....	11
Neni 16 - Përgjegjësia penale individuale	11
Neni 17 - Non-bis-in-idem	12

Neni 18- Amnistia	12
KAPITULLI IV - RREGULLAT E PROCEDURËS DHE PROVAVE.....	12
Neni 19 - Rregullat e procedurës dhe provave	12
Neni 20 - Gjuhët zyrtare dhe të punës	13
Neni 21 - Të drejtat e të akuzuarit	13
Neni 22 - Të drejtat e viktimave	14
Neni 23 - Mbrojtja e Viktimave dhe e Dëshmitarëve.....	16
KAPITULLI V - ORGANIZIMI, STRUKTURA DHE KOMPETENCAT	16
Neni 24 - Organizimi i Dhomave të specializuara dhe i Prokurorisë së specializuar	16
Neni 25 - Përbërja e Dhomave	17
Neni 26 - Regjistri i gjyqtarëve ndërkombëtarë.....	17
Neni 27 – Kualifikimet e gjyqtarëve të Dhomave të specializuara	18
Neni 28 - Emërimi i gjyqtarëve	18
Neni 29 - Vendet e lira në regjistër	19
Neni 30 – Kompetencat dhe statusi i gjyqtarëve.....	19
Neni 31 - Pavarësia e gjyqtarëve	19
Neni 32 - Emërimi dhe Funkcionet e Kryetarit dhe Nënkyetarit	20
Neni 33 - Caktimi i gjyqtarëve dhe përbërja e paneleve.....	20
Neni 34 - Zyra Administrative	22
Neni 35 - Prokurori i Specializuar	24
Neni 36 – Deklarata solemne	26
KAPITULLI VI – ZHVILLIMI I PROCEDURAVE PARA DHOMAVE TË SPECIALIZUARA	26
Neni 37 - Provat e Mbledhura Para Themelimit të Dhomave të Specializuara.....	26
Neni 38 - Hetimet dhe përgatitja e aktakuzës	27
Neni 39 - Kompetencat dhe funksionet e Gjyqëtarit të Procedurës paraprake.....	28
Neni 40 – Kompetencat dhe Funkcionet e Trupit Gjykses	29
Neni 41 - Paraburgimi	31
Neni 42 – Fletëthirrjet për dëshmitarët.....	33
Neni 43 - Aktgjykimi.....	34
Neni 44 – Dënimet.....	34
Neni 45 – Ankesat e ndërmjetme	35
Neni 46 – Procedurat ankimore në shkallë të dytë	35
Neni 47 – Procedurat ankimore në shkallë të tretë	36
Neni 48 – Mjetet juridike të jashtëzakonshme.....	37
Neni 49 – Peticioni në Gjykatën Kushtetuese.....	38
Neni 50 – Ekzekutimi i dënimit me burgim	39

Neni 51 - Falja ose ndërrimi i dënimeve.....	39
KAPITULLI VII – NDËRVEPRIMI ME GJYKATAT DHE SUBJEKTET E KOSOVËS	40
Neni 52 – Statusi, privilegjet dhe imunitetet e Dhomave të Specializuara në Kosovë	40
Neni 53 – Bashkëpunimi dhe asistenca gjyqësore.....	40
Neni 54 – Ndërveprimi me Gjykatat dhe Prokuroritë Tjera në Kosovë	42
KAPITULLI VIII – BASHKËPUNIMI DHE ASISTENCA ME SHETETET, ORGANIZATAT DHE SUBJEKTET E TJERA	42
Neni 55 – Kërkesat për asistencë dhe bashkëpunim	42
Neni 56 – Privilegjet dhe imunitetet	43
Neni 57 – Vuajtja e dënimit me burg	43
Neni 58 – Shtetet e Treta dhe Institucionet Ndërkombëtare.....	44
Neni 59 – Shteti pranues	44
KAPITULLI IX – ARANZHIMET FUNKSIONALE.....	44
Neni 60 – Aranzhimet e mbetura.....	44
Neni 61 – Menaxhimi i arkivave	44
Neni 62 – Kufizimet në qasje.....	45
Neni 63 - Buxheti dhe raportimi	45
Neni 64 – Interpretimi	45
Neni 65 – Hyrja në fuqi.....	46